

1 E martë, 21 shkurt 2023

2 [Deklarata hyrëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 9.30

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëmëngjesi. Mirë se erdhët.

8 Përpara se të fillojmë, dua t'u jap mundësinë fotografëve
9 të bëjnë disa fotografi. Ju lutem, bëni fotot.

10 Faleminderit.

11 Në zbatim me rregullin 124, paragrafi 1, i Rregullores së
12 Procedurës dhe Provave përpara Dhomave të Specializuara të
13 Kosovës, nis këtë gjykim.

14 Z. Sekretar i Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën, ose
15 zonjusha.

16 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Kjo është KSC-BC-2020-
17 04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.
18 Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Përpara se t'ju kërkoj personave të pranishëm në sallën e
21 gjyqit të prezantohen, dua t'ju kujtoj disa rregulla të cilat
22 duhen respektuar gjatë gjithë kohës.

23 Ju lutem, përpara se të flisni, siguroheni që e keni të
24 ndezur mikrofonin dhe fikeni sapo të mbaroni fjalën.

25 Flisni ngadalë dhe qartë. Kemi përkthyes nga/dhe drejt

1 shqipes dhe serbishtes, në mënyrë që dhe përkthyesit të bëjnë
2 siç duhet pjesën e tyre. Përpara se të ndërhyri, ju lutem
3 prisni pesë sekonda për t'u dhënë mundësi përkthyesve të
4 mbarojnë përkthimin e fjalisë paraardhëse.

5 Dua t'ju kujtoj që kjo seancë do të jetë e hapur përveç
6 nëse kërkohet ndryshe nga palët apo Mbrojtësi i Viktimave apo
7 nëse vendos ndryshe Trupi Gjykses. Kjo vlen veçanërisht për
8 deklaratat hyrëse që do të kemi sot edhe nesër.

9 Ju lutem palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave të paraqesin
10 deklaratat hyrëse, domethënë, sa më shumë që të jetë e mundur
11 në publik dhe të përdorin materiale audiovizuale dhe materiale
12 që mund t'i përcillen publikut. Sidoqoftë, dëshmitë
13 identifikuese, si fotografite e vendit të pretenduar të krimit
14 dhe të akuzuarit, parimisht nuk i duhen përcjellë publikut.

15 Dua t'u kujtoj palëve se ka informacione që janë objekt
16 masash mbrojtëse dhe urdhrash konfidencialiteti dhe si të
17 tilla nuk duhen nxjerrë. Nëse palët dhe Mbrojtësit e Viktimave
18 kanë parashtrime të cilat duhet të përfshijnë edhe informacion
19 konfidencial, më informoni paraprakisht që të kemi seancë
20 private ose të mbyllur.

21 Shkurtimisht do të përmend procedurat që palët dhe
22 Mbrojtësi i Viktimave duhet të ndjekin sa i takon për të
23 kërkuar redaktime në sallën e gjyqit.

24 Çdo kërkesë nga palët dhe Mbrojtësi i Viktimave gjatë
25 seancë për të redaktuar pjesë që nuk duhet të ishin thënë në

1 seancë publike duhet bërë me postë elektronike për të mos
2 tërhequr vëmendje të panevojshme për ndonjë informacion
3 konfidencial. Ky email do t'i dërgohet Trupit Gjykses, për
4 dijëni të sekretares së Gjykatës dhe përfaqësuesve të të
5 gjithëve subjekteve të tjerë të pranishëm në sallën e gjyqit.
6 Kërkesa duhet të specifikojë fjalët që duhen redaktuar, orët,
7 faqet dhe rreshtat në transkriptin në kohë reale. Kërkesat
8 duhen bërë sa më shpejt dhe jo më vonë se 15 pasi është marrë
9 informacioni. Të pranishmit në sallën e gjyqit kanë pesë
10 minuta për të paraqitur kundërshtime, nëse dëshirojnë,
11 kuptohet, rrjedhimisht, vendimin e merr Kryetarja e Trupit
12 Gjykses. Kjo është procedura e zakonshme.

13 Në rast se palët dhe Mbrojtësi i Viktimave gjykojnë se
14 është e nevojshme për të pasur seancë private, sigurisht që
15 është e mundur, po kjo duhet, sigurisht, justifikuar, në
16 mënyrë që të bëjmë një kërkesë për urdhër me gojë.

17 Procedura nuk cenon kompetencën e Trupit Gjykses *proprio*
18 *motu* për të vendosur për nevojën për redaktime dhe gjithashtu
19 redaktimet në sallën e gjyqit nuk cenojnë vlerësimin e
20 mëpasshëm të rishikuar nga Kryegjykatësja.

21 U lutem palëve, Mbrojtësit të Viktimave të prezantohen
22 dhe më pas fillojmë me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
23 Fjala është për ju.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Për Prokurorin e Specializuar
25 Alex Whiting, ushtrues i detyrës së Prokurorit të

1 Përgjithshëm; Giulia Bianchi, Gaia Pergolo, Eva Wyler dhe unë,
2 Filippo De Minicis, ndihmësprokuror.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Mbrojtësi i Viktimave.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë jam Simon Laws dhe
6 përfaqësoj viktimat në këtë çështje gjyqësore, së bashku me
7 bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska dhe ndihmësin tonë Kiat
8 Wei Ng.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Tani i jap fjalën avokatëve.

12 Fjala është për ju.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Unë jam Jean-Louis
14 Gilissen, nga Belgjika, avokat. Këtu jam me z. Pjetër Shala,
15 përfaqësoj z. Pjetër Shala. Do ju paraqes Hedi Aouini,
16 bashkëavokat, znjsh. Leto Cariolou, bashkëmbrojtëse; znj.
17 Katerina Charitou. Jemi këtu me znj. Katerina Charitou,
18 juriste nga Qipro; Dzeneta Petravica, Menaxhere e Çështjes;
19 edhe, Kailin Chen, nga Kina; Juliette Healy, asistente për
20 rishikimin e provave nga Franca; Francisca De Castro,
21 asistente për rishikimin e provave, po ashtu nga Franca; dhe,
22 Judit Kolbe nga Gjermania, gjithashtu përgjegjëse për
23 rishikimin e provave.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Faleminderit.

1 Tani e ka fjalën, Zyra Administrative.

2 Z. ROCHE: [Përkthim] Ralph Roche nga Zyra Administrative
3 dhe Shërbimet e Gjyqësorit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Faleminderit.

6 Për procesverbal, kolegët e Trupit Gjygues janë Gjykatës
7 Roland Dekkers, Gjykatës Gilbert Bitti dhe Gjykatës Vladimir
8 Mikula. Dhe emri im është Mappie Veldt-Foglia.

9 Mirë, do të fillojmë me urdhër me gojë nga Trupi Gjygues.

10 Mbrojtja ka paraqitur kundërshtime sa u takon referencave
11 që ka paraqitur Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe
12 Mbrojtësi i Viktimave për deklaratat e mëhershëm të të
13 akuzuarit që i ka dhënë si i dyshuar për Zyrën e Prokurorit në
14 Tribunalin Ndërkombëtar të ish-Jugosllavisë, që ka qenë në
15 2005 dhe në 2007; gjithashtu dhe një deklaratë që u ka dhënë
16 Policisë Gjyqësore Belge në 2016 dhe 2019. Mbrojtja argumenton
17 se pranueshmëria e tyre aktualisht po shqyrtohet nga Apeli.
18 Deklaratat janë marrë në shkelje të të drejtave të të
19 akuzuarit edhe është e papërshtatshme t'i marrësh parasysh, e
20 padrejtë dhe e cenueshme.

21 Kundërshtimi i Mbrojtjes ju komunikua Trupit Gjygues,
22 ZPS-së dhe Mbrojtësit të Viktimave me postën elektronike më 15
23 shkurt 2023 në orën 10.36 të paradites.

24 Trupi Gjygues merr parasysh përgjigjet e ZPS-së dhe
25 Mbrojtësit të Viktimave lidhur me këtë çështje, të cilat iu

1 komunikuan Trupit Gjykses, palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave
2 me postë elektronike, pra, me email, më 16 shkurt 2023 në orën
3 13.15 dhe 15.43 të pasdites.

4 Trupi Gjykses rikujton se më 6 dhjetor 2022, nxori vendim
5 lidhur me deklaratat e mëhershme të dhëna nga Pjetër Shala -
6 që është dosja F00364 - dhe aty vendosi se materialet që
7 lidhen me intervistat e të akuzuarit për TPNJ-në janë pranuar
8 si prova; dhe, se materialet që lidhen me intervistat e të
9 akuzuarit me autoritetet belge nuk janë të papranueshme dhe
10 prandaj mund të shqyrtohen nga Trupi Gjykses në përputhje me
11 rregullin 139(1) të Rregullores.

12 Më tej Trupi Gjykses rikujton se më 24 janar 2023 i
13 miratoi lejen Apelit, Mbrojtjes, pra, lejen për të apeluar
14 vendimin e mësipërm mbi tre pika. Kjo është dosja 401.
15 Mbrojtja paraqiti apelin më 13 shkurt të këtij viti edhe kjo
16 është parashtrimi i protokolluar IA006.

17 Trupi Gjykses, po ashtu, rikujton, se në bazë të
18 rregullit 171 të Rregullores, apelet e ndërmjetme nuk kanë
19 efekt pezullues, përveç nëse urdhërohet ndryshe dhe Mbrojtja
20 nuk bëri ndonjë kërkesë të tillë.

21 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se palët dhe
22 Mbrojtësi i Viktimave mund t'ju referohen deklaratave të
23 mëparshme që ka dhënë i akuzuari gjatë deklaratave të tyre
24 hyrëse.

25 Kini parasysh se procedurat në vazhdimësi para Gjykatës

1 së Apelit, Trupi Gjykues udhëzon palët dhe Mbrojtësin e
2 Viktimave, kur t'u referohen deklaratave të mëhershme të të
3 akuzuarit, të kenë parasysh faktin se çështja e pranueshmërisë
4 së tyre është ende duke u rishikuar nga Apeli, shqyrtuar nga
5 Apeli.

6 Këtu mbaron. Kjo mbyll edhe urdhrin me gojë të Trupit
7 Gjykues.

8 Seanca e sotme ka lidhje me procedurat e përcaktuara në
9 rregullin 124 dhe 125 të Rregullores dhe deklaratat hyrëse të
10 Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtësit të Viktimave në bazë
11 të rregullit 126 të Rregullores.

12 Këto deklaratat nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe
13 Mbrojtësi i Viktimave do t'i dëgjojmë në dy ose tre seanca
14 gjatë ditës së sotme. Fillojmë në orën 9.30, bëjmë një pushim
15 në 11.00. Rifillojmë në 11.30 deri në orën 13.00. Dhe nëse
16 është e nevojshme do të kemi një pushim tjetër dhe do të
17 rifillojmë në orën 14.30 të pasdites dhe nëse është e
18 nevojshme deri në 16.00 të pasdites.

19 Nesër paradite, do të dëgjojmë deklaratën hyrëse të
20 Mbrojtjes. Mbrojtja na ka informuar se z. Shala, po ashtu,
21 synon të bëjë një deklaratë jo nën betim në vijim të
22 përfundimit të deklaratave hyrëse të Mbrojtjes, pasi të
23 mbarojë Mbrojtja pra. Edhe shoh që pohon me kokë avokati.

24 Përpara se të fillojmë me procedurën e përcaktuar në
25 rregullin 124 dhe 125 të Rregullores, dua të tregoj, t'ju jap

1 një historik të shkurtër procedural të kësaj çështjeje
2 gjyqësore.

3 Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake
4 nxori vendimin mbi konfirmimin e aktakuzës kundër z. Shala dhe
5 po ashtu miratoi kërkesën për fletë-arrest dhe urdhër
6 transferimi për z. Shala.

7 Më 16 mars 2021, i akuzuari u arrestua në Belgjikë dhe u
8 transferua më 15 prill 2021 në objektin e paraburgimit të
9 Dhomave të Specializuara në Hagë.

10 Më 18 tetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake
11 miratoi pjesërisht mocionin paraprak të Mbrojtjes ku
12 pretendonte mangësi në aktakuzë dhe urdhëroi ZPS-në të
13 dorëzonte një version të korigjuar të aktakuzës së konfirmuar
14 që u bë, në fakt, nga ZPS-ja më 1 nëntor 2021.

15 Më 21 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ja
16 kaloi çështjen Trupit Gjykues I.

17 Më 26 janar të këtij viti, Trupi Gjykues caktoi datën për
18 fillim e gjykimit që është, në fakt, data sot, 21 shkurt.

19 Si Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Trupi Gjykues
20 kanë nxjerrë vendime mbi viktimat pjesëmarrëse gjatë
21 procedurave dhe zhdëmtimin e tyre dhe kemi tetë viktima
22 pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore.

23 Tani, siç është caktuar procedura në rregullin 124(2) të
24 Rregullores, kërkohet që gjykimi të vazhdojë me leximin e
25 aktakuzës nga ana e Prokurorit të Specializuar, çka është

1 konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Dhe është
2 përcaktuar në vendimin për fillimin e gjykimit, ne mendojmë,
3 se është e mjaftueshme për seancën e sotme, pra, duhen lexuar
4 akuzat e z. Shala sikurse dhe ndodhi dhe në paraqitjen e tij
5 paraprake.

6 Z. Prokuror, fjala është për ju.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

8 I akuzuari, z. Pjetër Shala, akuzohet me katër akuza për
9 krime lufte.

10 Pika 1, ndalim arbitrar, si krim lufte, i kryer në
11 fabrikën e metalit në Kukës për afërsisht mes 17 majit dhe 5
12 qershorit 1999, i ndëshkueshëm sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit
13 për Dhomat e Specializuara të Kosovës.

14 Pika 2, trajtim mizor, po ashtu krim lufte, i kryer në
15 fabrikën e metalit në Kukës për afërsisht mes 17 majit dhe 5
16 qershorit 1999, i ndëshkueshëm sipas nenit 14(1)(c)(i) të
17 Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës.

18 Pika 3, torturë, po ashtu krim lufte, i kryer në fabrikën
19 e metalit në Kukës për afërsisht midis 17 majit dhe 5 qershorit
20 1999, i ndëshkuar sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit.

21 Pika 4, vrasje e paligjshme, si krim lufte, e kryer më 5
22 qershor 1999 ose rreth asaj date në fabrikën e metalit në
23 Kukës, i ndëshkueshëm sipas nenit 14(1)(c)(i) të aktakuzës.

24 I akuzuari ngarkohet me këto vepra penale, në zbatim të
25 nenit 16(1)(a) të Ligjit, për tre format e përgjegjësisë

1 penale.

2 Së pari, akuzohet si anëtar i ndërmarrjes kriminale të
3 përbashkët, me qëllimin e përbashkët kryerjen e krimeve si
4 ndalimi arbitrar, trajtimi mizor, torturë dhe vrasje e
5 paligjshëm dhe akuzohet në Pikat 1 deri në 4 të aktakuzës,
6 sikurse paraqitet në Pikat 1 deri në 4 të aktakuzës.

7 I akuzuari ngarkohet se kishte synimin e mjaftueshëm për
8 secilën nga këto krime.

9 Si alternativë, më së paku ishte i parashikueshëm për të
10 akuzuarin se krimi i vrasjes së paligjshme mund të kryhej për
11 realizimit e qëllimit të përbashkët dhe e mori përsipër me
12 vullnet këtë rrezik.

13 Së dyti, i akuzuari ngarkohet si kryes fizik lidhur me
14 krimet e ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe torturës, të
15 paraqitura në Pikat 1 deri në 3 të aktakuzës.

16 Së fundmi, i akuzuari ngarkohet si ndihmues dhe
17 inkurajues për të gjitha krimet e paraqitura në Pikën 1 deri
18 në 4 të aktakuzës.

19 Dhe kjo është pjesa e akuzave, të nderuar Gjykatës.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit, z. Prokuror.

22 Z. Shala, ju lutem ngrihuni në këmbë.

23 Z. Shala, me sa kuptoj -- besoj se e kuptoni natyrën e
24 akuzave që ju paraqitën; kështu?

25 I AKUZUARI: Po. E kuptoj por s'pranoj asgjë. Se këto janë

1 të gjitha shpifje dhe trillime.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
3 Shala, do ju japim mundësinë të jepni deklaratën tuaj jo nën
4 betim.

5 Z. Shala, gjatë paraqitjes suaj paraprake më 19 prill
6 2021, ju u vetëdeklaruat i pafajshëm për të gjitha pikat në
7 aktakuzën e konfirmuar. Tani keni mundësinë të konfirmoni të
8 njëjtën deklaratë. A konfirmoni të njëjtin vetëdeklarim?

9 I AKUZUARI: Plotësisht i pafajshëm.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit, z. Shala. Mund të uleni.

12 Z. Shala, më lejoni t'ju informoj mbi të drejtat e
13 rëndësishme që gëzoni në këtë Gjykatë, në zbatim me kornizën
14 ligjore të kësaj Gjykate.

15 Keni të drejtën të heshtni dhe çdo heshtje -- heshtja nuk
16 merret parasysh për përcaktimin e fajësisë apo të pafajësisë
17 suaj.

18 Keni të drejtën të mos ndiheni i detyruar të
19 vetëdeklaroheni i fajshëm apo të dëshmoni.

20 Keni të drejtën të mos vetëinkriminoheni qoftë ju për
21 veten tuaj dhe as anëtarët tuaj të familjes së ngushtë.

22 Keni të drejtën të keni një avokat. Edhe këtu vë në dukje
23 se ju përfaqësoheni nga Mbrojtësi i specializuar z. Gilissen,
24 si dhe bashkëavokatët, z. Aouini dhe znjsh. Cariolou.

25 Keni të drejtën të keni kohën e mjaftueshme dhe

1 instrumentet për të përgatitur mbrojtjen tuaj dhe të
2 komunikoni me avokatët tuaj.

3 Keni të drejtën t'ju gjykojmë brenda një afati të
4 arsyeshëm.

5 Keni të drejtën të pyesni dëshmitarët kundër jush dhe të
6 merrni deklaratat dhe pyetjet që ju janë bërë dëshmitarëve në
7 emrin tuaj, për llogarinë tuaj.

8 Keni të drejtën të bëni një deklaratë jo nën betim, sa i
9 takon kësaj çështjeje gjyqësore, por gjithashtu ju mund të
10 paraqiteni dhe të thërriteni dhe si një dëshmitar nën betim.

11 Më duhet t'ju informoj, se në zbatim me rregullin 61(2)
12 të Rregullores, unë mund të urdhëroj t'ju largojnë
13 përkohësisht nga salla e gjyqit në rast se paraqisni ndonjë
14 sjellje të papërshtatshme gjatë gjykimit.

15 Në rregull?

16 Tani vazhdojmë me deklaratat hyrëse.

17 Pashë që z. Shala donte të thoshte diçka. Do jua japim
18 këtë mundësi nesër, kur avokati juaj mbrojtës të mbarojë
19 deklaratën e tij hyrëse, atëherë ju do bëni deklaratën tuaj
20 por jo nën betim. Do ju japim mundësinë të flisni.

21 Mirë, deklaratat hyrëse. Fillimisht dëgjojmë deklaratë
22 hyrëse nga Prokurori i Specializuar, më pas Mbrojtësi i
23 Viktimave.

24 Vendimi për fillimin e gjykimit ka caktuar dy orë për
25 secilën deklaratë hyrëse. Dje na informuan, mbrëmë, në fakt,

1 nga Zyra e Prokurorit të Specializuar se kanë rishikuar kohën
2 që u nevojitet për deklaratat hyrëse dhe parashikojnë rreth
3 një orë e 15 minuta për deklaratat hyrëse.

4 Prokurori e shoh që pohon me kokë që kështu është.

5 Z. Prokuror, fjala është për ju.

6 Z. WHITING: [Përkthim] Mirëmëngjes. Të nderuar Gjykatës,
7 avokatë, si ushtrues i detyrës së Prokurorit të Specializuar,
8 është privilegj i jashtëzakonshëm që të kem mundësinë të flas
9 përpara Trupit Gjykses në fillim të këtij gjykimi. Përpara se
10 të trajtoj çështjen gjyqësore në fjalë, më lejoni të them disa
11 fjalë lidhur me situatën në të cilën ne gjendemi aktualisht si
12 institucion.

13 Në këtë Gjykatë kemi pasur arritje shumë të mëdha dhe
14 disa gjëra që janë arritur për të parë. Kemi pasur aktakuzën e
15 parë, arrestimet e para, seancat e para paraprake, gjykimin e
16 parë, aktgjykimin e parë, dënimin e parë, apelin e parë. Tani
17 i kemi kaluar të gjitha këto arritje fillestare të para dhe
18 kemi kaluar në një fazë tjetër të ndryshme. Tani, ne jemi një
19 institucion që funksionon në mënyrë të plotë, jemi me baza të
20 thella dhe i provuar. Një institucion i cili ka demonstruar që
21 mund të arrijë rezultate, që mund të gjykojë çështje gjyqësore
22 brenda mandatit të saj në mënyrë të drejtë dhe të efektshme
23 edhe shpesh nën situata që janë sfiduese dhe të
24 jashtëzakonshme.

25 Dhe meritën për këto arritje e kanë shtetet të cilat e

1 kanë krijuar këtë Gjykatë dhe që vazhdojnë ta mbështesin atë.
2 Po kështu meritë kanë edhe punonjësit e dedikuar të këtij
3 institucioni. Punonjësit e Zyrës së Prokurorit të
4 Specializuar, të zyrës së Kryetares, të Dhomat e
5 Specializuara, të Zyrës Administrative, të Përfaqësuesit të
6 Viktimave dhe të Palës Mbrojtëse. Por mbi të gjithë, të
7 nderuar Gjykatës, meritën e kanë ata në Kosovë të cilët e kanë
8 mbështetur punën e kësaj Gjykate dhe në mënyrë të veçantë,
9 viktimat dhe dëshmitarët, të cilët kanë treguar guxim të
10 jashtëzakonshëm duke ardhur në këtë sallë gjyqi, duke u ulur
11 në atë karrige aty për të dhënë dëshminë e tyre.

12 Gjykatësit e kësaj Gjykate, në mënyrë të vazhdueshme,
13 përmes aktgjykimeve, vendimeve dhe urdhrave të tyre, kanë
14 konstatuar që vazhdon që të ekzistojë një klimë e frikësimit
15 të dëshmitarëve në Kosovë. Është reale, serioze, e gjithanshme
16 dhe në vazhdim e sipër. Zyra jonë dhe ky institucion, herë pas
17 here, ka ndërmarrë veprime për t'ju kundërvënë kësaj klime,
18 duke mbrojtur dëshmitarët dhe duke marrë masa kundër çdokujt
19 që ka kërkuar që ta minojë në mënyrë të paligjshme këtë
20 institucion apo të frikësojë dëshmitarët. Dhe ne do të
21 vazhdojmë ta bëjmë një gjë të tillë. Ne do të vazhdojmë t'i
22 shfrytëzojmë të gjitha mjetet nën dispozicion për të bërë të
23 mundur që dëshmitarët të mund të vijnë në këtë sallë gjyqi për
24 të dhënë dëshminë e tyre në mënyrë të sigurtë.

25 Megjithatë, të nderuar Gjykatës, nuk ka dyshim që kjo

1 klimë e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve do të
2 vazhdojë të ndikojë dhe formësojë mënyrën sesi do të
3 zhvillohet ky gjyq. Do të peshojë kjo klimë mbi dëshmitarët që
4 vijnë në këtë sallë gjyqi për të dhënë dëshminë e tyre. Është
5 klima në të cilën ata dhe familjet e tyre jetojnë çdo ditë të
6 jetës. Është realitet në të cilin ato duhet të kthehen
7 menjëherë.

8 Dhe si kur dëgjoni dëshmitarët që vijnë në këtë sallë
9 gjyqi, të nderuar Gjykatës, gjatë këtij gjykimi dhe ata ulen
10 në këtë karrige, ndërkohë që ju shqyrtoni fjalët që ata thonë
11 dhe vlerësoni besueshmërinë e tyre, ne gjithmonë do t'ju
12 kërkojmë që të mos harroni rrethanat në të cilët ata po japin
13 dëshminë e tyre, klimën e vazhdueshëm të frikës dhe të
14 frikësimit dhe të kërcënimit dhe efektin që kjo klimë mund të
15 ketë mbi dëshmitë që japin.

16 Në fund të fundit, i nderuar Gjykatës, sukcesi i këtij
17 institucioni përbën sukses edhe për Kosovën. Kundërshtarët e
18 kësaj Gjykate në mënyrë të vazhdueshme kanë kërkuar të
19 pretendojnë që ajo është kundër Kosovës dhe kundër UÇK-së, por
20 asgjë nga kjo nuk është e vërtetë. Kjo është një Gjykatë e
21 Kosovës, e krijuar nga Kuvendi i Kosovës, me mbështetjen dhe
22 bashkëpunimin ndërkombëtar, Gjykatë e cila është brenda
23 kuadrit, sistemit ligjor të Kosovës.

24 Çështjet gjyqësore para kësaj Gjykate nuk janë kundër
25 Kosovës dhe kundër UÇK-së. Ato janë çështje kundër individëve

1 të cilët pretendohet se kanë kryer krime gjatë luftës.

2 Për më tepër, në të gjitha çështjet gjyqësore para kësaj
3 Gjykate, të nderuar Gjykatës, përfshirë këtë aktualen, shumica
4 e viktimave janë shqiptarë të Kosovës dhe disa raste të gjitha
5 viktimat janë shqiptarë të Kosovës.

6 Kjo Gjykatë pohon parimin e shtetit të së drejtës në
7 Kosovë, përfshirë të drejtën e personave që akuzohen për krime
8 lufte për t'u gjykuar në mënyrë të drejtë. Dhe po kështu
9 nënvijëzon, që askush nuk është mbi ligjin dhe që personat, të
10 cilët janë akuzuar për kryerjen e krimeve ndërkombëtare duhet
11 të nxirren përpara përgjegjësisë, pavarësisht se për cilën
12 kauzë kanë luftuar. Ky parim, i nderuar Gjykatës, është një
13 parim që zbatohet për të gjitha ushtritë, përfshirë UÇK-në.

14 Dhe në këtë, më lejoni të jem i qartë në këtë pikë. Sa e
15 drejtë është një kauzë apo besimi në një kauzë të caktuar,
16 pavarësisht sesa i fuqishëm është ky besim, nuk u jep imunitet
17 atyre të cilët dhunojnë ligjet e luftës dhe kryejnë krime
18 lufte. Ata janë përgjegjës para ligjit, njësoj si gjithë të
19 tjerët dhe pavarësisht se për cilën kauzë luftojnë.

20 Çështja gjyqësore që fillon sot, i nderuar Gjykatës,
21 kundër të akuzuarit Pjetër Shala, në fakt, është shumë e
22 thjeshtë edhe pse ka ndryshuar në mënyrë tragjike jetën e
23 shumë njerëzve dhe i ka dhënë fund jetës së një personi të
24 caktuar. Dëshmitë do të tregojnë se në pranverën e 1999, në
25 Kukës, në veri të Shqipërisë, i akuzuari ka kryer krimin e

1 luftës së ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe
2 vrasjes së paligjshme. Po kështu dëshmitë do të tregojnë se z.
3 Shala ishte pjesë e një grupi të vogël ushtarësh të UÇK-së të
4 cilët i kanë kryer këto krime. Ky grup përfshinte Sabit Gecin
5 dhe Xhemshit Krasniqin, të dy të shpallur fajtorë në dy gjyqe
6 në Kosovë për krimin e ndalimit arbitrar dhe të keqtrajtimit
7 të zhvilluar në fabrikën e metaleve në Kukës.

8 Aktakuza e kësaj çështjeje gjyqësore pretendon se ky grup
9 kriminal që përfshinte të akuzuarin, ka ndaluar dhe
10 keqtrajtuar në mënyrë barbare të paktën 18 viktima në qendrën
11 e ndalimit që ndodhej brenda territorit të fabrikës të ish-
12 fabrikës së metalit në Kukës. Ky grup kriminal, përfshirë të
13 akuzuarin, ka vrarë njërin prej këtyre viktimave natën mes 4
14 apo 5 qershorit 1999 apo afërsisht në atë kohë.

15 Viktimat e kësaj çështjeje janë shënjestruar për shkak të
16 afërsisë së perceptuar që kishin me serbët, janë trajtuar
17 spiunë dhe bashkëpunëtorë të cilët e kanë merituar dënimin dhe
18 poshtërimin. Ato janë ndaluar pa asnjë proces të ligjshëm dhe
19 në kohën që janë mbajtur të ndaluar u janë nënshtruar
20 abuzimit, torturës dhe në një rast të vrasjes dikë në mënyrë
21 të ashpër dhe vazhdueshme.

22 Le të jemi të qartë. Abuzimi me synim i të ndaluarve
23 gjatë një konflikti të armatosur është një krim lufte,
24 thjesht, e thjeshtë është kjo dhe nuk mund të justifikohet
25 asnjëherë dhe pavarësisht rrethanave. Nuk ka asnjë justifikim

1 për abuzim, torturë apo për vrasjen e të ndaluarve. Ligjet e
2 luftës nuk e lejojnë një gjë të tillë, jo as në këtë konflikt
3 dhe as në ndonjë konflikt tjetër.

4 I akuzuari, Pjetër Shala, ka marrë pjesë në të gjitha
5 aspektet e krimeve të pretenduara të kësaj çështjeje
6 gjyqësore. Ai ishte i pranishëm në fabrikën e metalit në Kukës
7 në kohë të rëndësishme gjatë periudhës që përfshinë aktakuza.
8 Ai ka marrë pjesë në të paktën arrestimin e një personi dhe
9 transferimin e një të burgosuri në këtë pikë të ndalimit. Ai
10 ka kontribuar në mbajtjen e kushteve çnjerëzore të ndalimit në
11 këtë pikë të ndalimit ku përfshiheshin dhoma të tejmbushura
12 dhe të pista dhe ushqim i pamjaftueshëm. Ai ka marrë pjesë në
13 rrahjen e vazhdueshme dhe të ashpër të të burgosurve në këtë
14 pikë të ndalimit që përfshinin rrahjen me shufra hekuri dhe me
15 objekte të mprehta. Si rezultat i këtyre rrahjeve, viktimat
16 janë mbuluar me gjak, kanë pësuar nga thyerja e eshtrave dhe
17 nuk kanë qenë në gjendje të ecin me këmbët e tyre.

18 I akuzuari po kështu ka qenë pjesë i një grupi i cili ka
19 vrarë njërin prej të ndaluarve duke e rrahur atë në mënyrë të
20 vazhdueshme dhe të ashpër dhe duke e gjuajtur me armë në
21 këmbë, duke bërë që ai të kishte hemorragji që ka shkaktuar
22 vdekjen e tij gjatë një periudhe që ka zgjatur disa orë.

23 Pas disa çastesh, ekipi që trajton këtë gjykim do të japë
24 hollësi të mëtejshme lidhur me rrethanat e këtyre krimeve,
25 lidhur me vendndodhjen e fabrikës së metalit në Kukës, lidhjen

1 me konfliktin e armatosur dhe përgjegjësinë e të akuzuarit.

2 Por përpara se t'ia jap fjalën ekipit tim për të vazhduar
3 me deklaratën hapëse edhe një koment përfundimtar. Prokuroria
4 dhe Mbrojtja janë dakord mbi një gjë dhe kjo është se i takon
5 vetëm Prokurorisë barra për të provuar këto krime të
6 pretenduara tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Është kjo një barrë
7 që ne e pranojmë dhe e mirëpresim dhe të cilën do ta
8 realizojmë. Pala Mbrojtëse nuk e ka këtë barrë dhe ka të
9 drejtën që të qëndrojë e heshtur gjatë gjithë procedurave
10 gjyqësore.

11 Por, i nderuar Gjykatës, Pala Mbrojtëse nuk ka qëndruar e
12 heshtur dhe për sa u përket qëndrimit që kanë mbajtur lidhur
13 me pretendimet e krimeve, Trupi Gjykses duhet t'i shqyrtojë
14 ato gjatë vlerësimit të provave që paraqiten. Në këtë rast,
15 Pala Mbrojtëse ka mohuar çdo gjë, që i akuzuari nuk ka
16 arrestuar apo transferuar askënd; nuk ka marrë pjesë në
17 ndalimin e askujt; nuk ka mbajtur kushte çnjerëzore; nuk ka
18 abuzuar asnjë prej të burgosurve, asnjërin dhe, në fakt, nuk
19 ka qenë as fare në Kukës në kohën kur është vrarë i ndaluari.
20 Për sa i përket të akuzuarit asnjë prej këtyre gjërave nuk ka
21 ndodhur. Asnjë.

22 Të nderuar Gjykatës, kur të dëgjoni dëshmitarët që do të
23 thërrasë pala e Prokurorisë dhe të vlerësoni deklaratat të
24 cilat janë paraqitur si prova materiale, mbani parasysh, të
25 nderuar Gjykatës, këto mohime të tërësishme të bëra nga i

1 akuzuari i kësaj çështjeje gjyqësore. Përse pretendon që nuk
2 ka lidhje fare me atë që ka ndodhur në Kukës? Përse po
3 përpiqet që ta distancojë veten e tij sa më shumë që të jetë
4 e mundur nga ajo që ka ndodhur në Kukës?

5 Dhe në masën që Trupi Gjykses do të shqyrtojë deklaratat
6 e mëparshme të dhëna nga z. Shala, pranimi i të cilave si
7 provë materiale është kundërshtuar nga Pala Mbrojtëse dhe që
8 po shqyrtohet tashmë nga Paneli i Gjykatës së Apelit të kësaj
9 Gjykate, të cilat do t'i diskutojmë më në hollësi në fund të
10 kësaj deklarate hyrëse, ju do të donit të shqyrtoni nëse këto
11 pranime të fajësisë të bëra nga i akuzuari në deklaratat e tij
12 të mëparshme janë në përputhje me mohimin që bën tani që
13 është, në fakt, ngarkuar me këto krime.

14 Siç do të shpjegohet më në hollësi nga kolegët e mi, ne
15 jemi të bindur se dëshmitë që do të paraqiten gjatë këtij
16 gjykimi do të vërtetojnë më tej, tej dyshimit të arsyeshëm se
17 z. Shala mban përgjegjësi penale për krimet e paraqitura në
18 aktakuzë.

19 Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

20 Dhe tani ja jap fjalën znj. Pergolo që do të vazhdojë me
21 deklaratën hyrëse të Prokurorisë.

22 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, gjatë kësaj
23 pjese të paraqitjes, unë do të diskutoj vendndodhjen e krimeve
24 të cilët janë paraqitur të kryera sipas aktakuzës së kësaj
25 çështjeje. Së pari, do të jap informacion gjeografik dhe

1 kontekstual lidhur me fabrikën e metalit në Kukës. E dyta, do
2 të shpjegoj sesi fabrika e metalit në Kukës është e lidhur me
3 konfliktin e armatosur në Kosovë dhe sesi është shfrytëzuar
4 ajo nga UÇK-ja gjatë periudhës së aktakuzës. E treta, do t'ju
5 dërgoj në një vizitë virtuale në këtë vendndodhje, duke
6 ndaluar në disa pika të veçanta ku janë zhvilluar disa nga
7 ngjarjet kyçe.

8 Të nderuar Gjykatës, tani do të shfrytëzoj një prezantim
9 PowerPoint. Të tre diapozitivët e parë mund t'i paraqiten
10 publikut.

11 Qyteti i Kukësit është fund të malit të Gjallicës dhe
12 mbikëqyr pikën e bashkimit të Drinit të Bardhë dhe të Zi, në
13 pjesën veriore të Shqipërisë, pra, rreth 20 kilometra nga
14 kufiri i Kosovës.

15 Fabrika e metalit në Kukës ndodhet në periferi të qytetit
16 të Kukësit, afërsisht 1 kilometër e gjysëm deri në 2 kilometra
17 nga qendra e qytetit të Kukësit në rrugën që shkon për Krumë,
18 siç tregohet edhe nga pika e kuqe në ekran.

19 Të nderuar Gjykatës, sipas udhëzimeve që na keni dhënë,
20 pjesa tjetër e prezantimit nuk do të duhet të transmetohet
21 publikisht.

22 Kjo është një pamje nga veri-jug e fabrikës së metalit në
23 Kukës në rrugën që shkon në Krumë në të djathtë të kësaj
24 fotografie. Fabrika e metalit në Kukës kishte një portë hyrëse
25 në të cilën hyje nga rruga që shkon në Krumë dhe një kabinë

1 roje në të majtë të kësaj porte, një ndërtesë të komandës ku
2 ushtarët e UÇK-së dhe oficerët janë strehuar në kohën që kanë
3 qëndruar në këtë fabrikë, një numër depush, një oborr të
4 brendshëm dhe një ndërtesë të vogël e cila dilte brenda
5 territorit të oborrit.

6 Ky është vendi i një ish-fabrike të përpunimit të metalit
7 dhe ka qenë dikur pronë e shtetit shqiptar. Është privatizuar
8 në vitin 1998 dhe Dëshmitari 4379 u bë pronar i saj dhe e ka
9 shfrytëzuar për arsye private fillimisht.

10 Disa ditë pas fillimit të bombardimit të NATO-s më 24
11 mars 1999, një anëtar i UÇK-së i kërkoi Dëshmitarit 4379 që ta
12 shfrytëzonte këtë fabrikë dhe me këtë ai ra dakord.

13 UÇK-ja e shfrytëzoi këtë fabrikë për tre muaj deri
14 afërsisht qershorit dhe korrikut të 1999.

15 Fabrika e metalit në Kukës është shfrytëzuar gjatë
16 konfliktit të armatosur dhe lidhur me konfliktin e armatosur
17 që ka ekzistuar gjatë periudhës së aktakuzës, në mes, nga
18 njëra anë forcave serbe, në veçanti, forcave të ushtrisë së
19 Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Ministrisë së
20 Brendshme të Serbisë, me shkurtesën MUP dhe nga ana tjetër
21 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pra, UÇK. Ekzistenca e
22 konfliktit të armatosur gjatë periudhës përkatëse është
23 vërtetuar nga gjykatat e tjera, në mënyrë të veçantë TPNJ-ja
24 dhe nga ky Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore Prokurori i
25 Specializuar kundër Salih Mustafës. Në atë çështje penale, ky

1 Trup Gjykues ka konstatuar se të paktën nga fundi i majit
2 1998, luftimet e armatosura në Kosovë mes forcave serbe dhe
3 UÇK-së kishin arritur nivelin e duhur të intensitetit që të
4 shqyrtoheshin, që të përbënin një konflikt të armatosur. Ky
5 Trupi Gjykues po kështu ka miratuar konstatimet e TPNJ-së se
6 nga maji i 1998 UÇK-ja ka pasur një nivel të mjaftueshëm të
7 organizimit që të ishte në gjendje që të merrte pjesë në një
8 konflikt të armatosur me karakter jo-ndërkombëtar. Trupi
9 Gjykues i Gjorgjeviçit në TPNJ dhe Gjykata Supreme e Kosovës
10 në çështjen Latif Gashi, po kështu, kanë konstatuar që
11 konflikti i armatosur në Kosovë ka vazhduar gjatë periudhës së
12 aktakuzës së kësaj çështjeje gjyqësore.

13 Si rezultat i luftimeve të armatosura në Kosovë midis
14 fundit të marsit dhe majit të vitit 1999, një numër i madh
15 refugjatësh janë arratisur nga Kosova dhe janë vendosur në
16 Bashkinë e Kukësit. Disa nga këta refugjatë kanë përfunduar në
17 fabrikën e metalit në Kukës, e cila, siç është përmendur më
18 herët, kontrollohej në atë periudhë nga UÇK-ja.

19 Fabrika e metalit në Kukës është shfrytëzuar si bazë për
20 rekrutimin, mobilizimin dhe për çështje logjistike. Rekrutët e
21 UÇK-së kanë marrë aty armë dhe uniforma dhe më pas janë
22 dërguar për t'u stërvitur përpara se të dërgoheshin në frontin
23 e luftës.

24 Përveç shfrytëzimit për të arritur synimet luftarake të
25 UÇK-së, fabrika e metalit në Kukës është shfrytëzuar po kështu

1 edhe për të ndaluar, marrë në pyetje dhe keqtrajtuar individë
2 të cilët konsideroheshin se ishin spiunë dhe bashkëpunëtorë të
3 Serbisë.

4 Individët të cilët janë burgosur në fabrika e metalit në
5 Kukës kanë arritur aty për një numër arsyesh të ndryshme dhe
6 në mënyra të ndryshe. Disa arritën tek kjo fabrikë në mënyrë
7 vullnetare; të tjerët janë dërguar me forcë.

8 Për shembull, Dëshmitari 4-01 shkoi në Shqipëri në maj të
9 vitit 1999. Me të arritur në Kukës, ai shkoi tek fabrika e
10 metalit në Kukës. Të nderuar Gjykatës, një fat i tmerrshëm e
11 ka pritur atë. Siç do të tregohet me prova, Dëshmitari 4-01 i
12 është nënshtruar keqtrajtimit, torturës dhe rrahjeve për shkak
13 se dyshohej se ishte spiun.

14 Dëshmitari 4-11 u largua nga Komuna e Prizrenit në Kosovë
15 në mars të vitit 1999, së bashku me familjen e tij, për shkak
16 të sulmeve të forcave serbe. Ai shkoi në Shqipëri duke
17 udhëtuar me këmbë dhe u vendos në një kamp refugjates në Kukës
18 në prill të 1999. Por një muaj më vonë, në maj të vitit 1999,
19 Dëshmitari 4-11 u takua me dy anëtarë të UÇK-së të cilët i
20 thanë se duhet të jepte një deklaratë dhe në këtë pikë atë e
21 kanë marrë dhe e kanë dërguar në fabrika e metalit në Kukës,
22 ku e kanë mbajtur të ndaluar për rreth një muaj.

23 Dëshmitari 4733 u arratis nga Kosova në prill të 1999 së
24 bashku me familjen e tij. Si refugjat në Shqipëri, ai nuk ka
25 pasur një fat më të mirë, pasi është rrëmbyer nga anëtarë të

1 UÇK-së në maj të 1999 dhe dërguar në fabrikën e metalit në
2 Kukës. Atje ai është nënshtruar keqtrajtimit dhe torturës,
3 pasi u akuzua se nuk ka dhënë dorëheqjen nga roli i oficerit
4 të policisë në institucionet serbe në vitet 1990.

5 Të nderuar Gjykatës, dëshmitë do të tregojnë se të gjithë
6 individët të cilët janë mbajtur të ndaluar në fabrikën e
7 metalit në Kukës ishin civilë të cilët nuk kanë marrë pjesë në
8 luftime të armatosura, nuk kanë marrë pjesë aktive në luftime
9 të armatosura. Kryesit kanë qenë të gjithë anëtarë të UÇK-së,
10 përfshirë të akuzuarin, Pjetër Shalën.

11 Të nderuar Gjykatës, tani dua tregoj, me ndihmën e
12 materialeve vizuale disa nga pikat brenda kësaj fabrike të
13 metalit në Kukës ku kanë ndodhur edhe ngjarjet kyçe. Për ta
14 bërë këtë, do të shfrytëzoj një model tredimensional të
15 fabrikës së metalit në Kukës që ZPS-ja ia ka dërguar më parë
16 Trupit Gjykues, Palës Mbrojtëse dhe Mbrojtësit të Viktimave.

17 Ky model 3D është krijuar vetëm për t'u shfrytëzuar vetëm
18 në këtë prezantim tonin dhe është krijuar mbi bazën e hartave
19 kadastrale të vjetra dhe të reja të fabrikës së metalit në
20 Kukës dhe të fotografimit që ka marrë ZPS-ja gjatë vizitave që
21 ka bërë në këtë vend. Këtë e shfrytëzojmë për t'i treguar të
22 gjithë të pranishmëve në këtë sallë gjyqi sesi duket kjo
23 ndërtesë, ku janë të vendosura disa prej ndërtesave dhe ku
24 janë këto ndërtesa lidhur njëra me tjetrën. Së bashku me
25 modelin 3D, do të tregojmë edhe fotografi të fabrikës së

1 metalit.

2 Fillojmë me një pamje ajrore të fabrikës së metalit në
3 Kukës të cilën ju e keni parë më herët. Dhe ndërkohë që
4 largohet kjo fotografi, do të shihni modelin 3D të pamjes
5 ajrore.

6 Ne tani do ta zmadhojmë për t'u afruar tek porta e
7 hyrjes. Tani do të shihni një fotografi të portës në të majtë
8 të ekranit dhe ajo bashkë apo ngjitur me modelin 3D.

9 Dhe tani do të hyjmë brenda në ndërtesë dhe të shohim në
10 të majtë ku do të shohim kabinën e rojës. Dhe asaj, që të
11 cilën ne do ta quajmë ndërtesa e komandës.

12 Tani të hyjmë në oborrin e brendshëm, ku së pari shikohet
13 ndërtesa e komandës nga qoshja veri-perëndimore. Dhe, në të
14 majtë, kemi një pamje ballore të ndërtesës së komandës.

15 Kjo ndërtesë është një strukturë e ndërtuar me beton me
16 dy kate, brenda së cilës ka pasur një numër zyrash të cilat
17 janë shfrytëzuar edhe si zyra edhe për strehimin e ushtarëve
18 të UÇK-së. Ka ekzistuar dhe një farmaci atje dhe një zyrë ku
19 një i ashtuquajtur prokuror apo gjykatës i UÇK-së merrte në
20 pyetje ata të cilët dyshoheshin se ishin bashkëpunëtorë.

21 Dëshmitë do të tregojnë se disa dëshmitarë, përfshirë
22 4733 dhe 1448, janë mbajtur të ndaluar në këtë ndërtesë në maj
23 të 1999, janë marrë në pyetje dhe janë keqtrajtuar.

24 Më tutje, në këtë ndërtesë, kanë ndodhur disa nga rrahjet
25 më brutale më 20-21 maj 1999 apo rreth asaj date, periudha kur

1 4733, 1448, Dëshmitari 4-01 si dhe viktimat e vrasjes së
2 paligjshme janë torturuar nga anëtarë të caktuar të UÇK-së,
3 përfshirë dhe të akuzuarin.

4 Tani t'i largohemi ndërtesës së komandës dhe do të
5 kthehem në të djathtë, duke ecur në drejtim të akrepave të
6 sahatit brenda fabrikës së metalit dhe do të shohim një nga
7 depot të cilët ndodhen në anën tjetër të oborrit.

8 Në vazhdimësi, shohim një ndërtesë të vogël e cila del
9 brenda territorit të oborrit.

10 Modeli tredimensional tregon strukturën siç ka ekzistuar
11 në kohën e ngjarjeve dhe kjo mund të shihet edhe në këtë
12 fotografi. Që nga ajo kohë, kjo ndërtesë është shkatërruar
13 pjesërisht dhe tani duket si kjo fotografia që po tregojmë.
14 Shikojmë këtë me këtë shigjetë pjesën me tulla të kuqe e cila
15 mbetet ende në këmbë dhe korrespondon me pjesën e fundit të
16 ndërtesës siç ka ekzistuar në kohën e atëhershme.

17 Dëshmitë që do të tregojë ZPS-ja do të dëshmojnë që
18 viktimat janë mbajtur në këtë ndërtesë, të cilën do ta quajmë
19 ndërtesa e ndalimit dhe janë mbajtur aty gjatë gjithë kohës së
20 ndalimit në fabrika e metalit në Kukës, janë mbajtur në kushte
21 të rënda dhe ju janë nënshtruar torturës dhe keqtrajtimit. Dhe
22 kjo, në mënyrë më domethënëse, është edhe ndërtesa ku viktimat
23 e vrasjes së paligjshme është sulmuar në mënyrë brutale,
24 rrahur, gjuajtur me armë dhe vrarë në natën mes 4 dhe 5
25 qershorit 1999 apo rreth asaj kohe.

1 Dhe, në fund, në depon që ndodhet përballë ndërtesës së
2 ndalimit, që mund ta shohim këtë në të djathtë të modelit
3 tredimensional dhe në këtë fotografi ishin nevojtoret.

4 Dëshmitarët që do të thërrasë ZPS-ja për të dhënë dëshmi do të
5 shpjegojnë sesi janë ngacmuar kur shkonin nga ndërtesa e
6 ndalimit për në tualet, për në banjë.

7 Tani do të largohemi nga kjo pamje dhe të shohin përsëri
8 hartën fillestare kadastrale të fabrikës së metalit në Kukës.

9 Të nderuar Gjykatës, këtu përfundon pjesa që unë kisha në
10 këtë prezantim. Kolegia ime, Eva Wyler do të tregojë tani se
11 cilat janë dëshmitë që do të shfrytëzojë ZPS-ja për të provuar
12 krimet e paraqitura në këtë çështje gjyqësore.

13 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dëshmitë që do të tregojnë ZPS-ja
14 në këtë çështje nuk do të lënë asnjë dyshim që krimet e
15 paraqitura në aktakuzë kanë ndodhur në fabrikën e metaleve në
16 Kukës në kohën e aktakuzës.

17 Të nderuar Gjykatës, ju do të dëgjoni dhe do të shikoni
18 prova të mënyrës sesi viktimat u rrëmbyen dhe u dërguan për
19 ndalim në fabrikën e metaleve të Kukësit, përfshirë edhe disa
20 prej dëshmitë dhe provat e vetë viktimave. Viktimat do të
21 dëshmojnë rreth ndalimit të tyre në fabrikën e metaleve në
22 Kukës, personat që ata kanë njohur atje, kushtet çnjerëzore të
23 ndalimit të tyre, torturën dhe trajtimin mizor që kanë kaluar
24 atje, si dhe kush ishin torturuesit e tyre. Ata gjithashtu do
25 të raportojnë për lëndimet e rënda fizike dhe psikologjike që

1 kanë pësuar, disa prej të cilave vazhdojnë edhe sot e kësaj
2 dite të kenë ndikim mbi viktimat dhe familjet e tyre.

3 Individët e etiketuar ishin thujtse tërësisht shqiptarë
4 të Kosovës dhe disa prej tyre kishin etni rome. Ata ishin të
5 gjithë civilë. Ata u rrëmbyen, u ndaluan, u keqtrajtuuan me
6 dyshimin se ishin bashkëpunëtorë. Asnjëri prej tyre megjithatë
7 në kohën e arrestimit të tyre nuk kishte marrë pjesë në
8 luftime në atë kohë. Disa prej tyre sapo kishin arritur në
9 Shqipëri nga Kosova. Ndërkohë që të tjerë ishin mbështetës të
10 UÇK-së me donacione, me furnizime me ushqim dhe sërish disa të
11 tjerë thjeshtë dëshironin që të qëndronin jashtë lufte. Askush
12 nga të ndaluarit nuk mori asnjë arsye të vlefshme lidhur me
13 mënyrën dhe arsyen se përse ishin ndaluar dhe nuk ju dha
14 askujt prej tyre asnjë dokument arrestimi.

15 Dëshmitari 04733, një shqiptar i Kosovës që jeton me
16 familjen e tij në Cermjan në Komunën e Gjakovës, ishte njëri
17 prej këtyre viktimave. Ai ishte larguar nga Kosova drejt
18 Durrësit, në Shqipëri, në prill të vitit 1999. Pasi kishin
19 mbërritur aty, pjesëtarë të UÇK-së filluan në mënyrë të
20 vazhdueshme që të vizitonin shtëpinë ku qëndronte Dëshmitari
21 04733 dhe familja e tij, duke u munduar që ta rrëmbejnë atë.
22 Në mes të majit të vitit 1999, Policia Ushtarake e UÇK-së ia
23 arriti ta bënte këtë gjë dhe e rrëmbeu 04733. Atë e mbajtën në
24 Romanat, në Shqipëri, për tre ditë dhe më pas e dorëzuan tek i
25 akuzuari, së bashku me pjesëtarë të tjerë të UÇK-së, për ta

1 transferuar në Kukës.

2 Ata e dërguan 07433 në fabrikën e përpunimit të metaleve
3 në Kukës në mbrëmje vonë të datës 20 maj 1999 ose rreth kësaj
4 date. Ai u dërgua në ndërtesën e komandës, ndërtesa që është
5 në majtë në momentin kur futesh tek porta kryesore në
6 ambientet e fabrikës. Atë e vendosën në një qeli të
7 improvizuar, në një qeli të ngushtë dhe pa dritë natyrale. Ai
8 aty u takua me Dëshmitarin 01448, i cili kishte ditë që mbahej
9 në të njëjtën qeli në Kukës.

10 Natën e mbërritjes së 04733 në Kukës në fabrikën e
11 metaleve atje kjo ishte në fakt, edhe nata kur ndodhën rrahje
12 brutale në ndërtesën e komandës dhe që këto rrahje janë
13 raportuar nga viktimat në këtë çështje, përfshirë këtu edhe
14 04733.

15 Menjëherë pasi u dërgua në qelinë e tij, 04733 u dërgua
16 në një tjetër dhomë në ndërtesën e komandës, ku u takua nga
17 një grup ushtarësh të UÇK-së, përfshirë këtu dhe të akuzuarin.
18 04733 iu kërkua që të pranonte që kishte vrarë 100 shqiptarë,
19 që kishte përdhunuar gra dhe iu kërkua gjithashtu që të
20 këndonte një këngë serbe. Më pas ata filluan ta rrihnin atë,
21 me grushte, me një shkop bejsbolli, me shkopinj prej gome, me
22 shufra të tjera dhe me pjesën e pasme të një revolveri. Ata i
23 prenë kyçet, e dogjën me cigare, i hodhën në plagët e tij
24 kripë dhe i thyen po ashtu edhe dhëmbët. 04733 u rrah në
25 mënyrë brutale derisa humbi ndërgjegjen. Kur e fitoi

1 ndërgjegjen, kur u përmend, ai ishte i lagur nga uji që ishte
2 derdhur sipër në mënyrë që të mund të merrte ndjenjat,
3 ndërkohë që e rrahura vazhdoi.

4 Edhe të ndaluarit e tjerë filluan që të silleshin në
5 dhomë. Dëshmitari 1448 dhe Dëshmitari i Gjykimit 4-01 e gjetën
6 4733 të mbuluar në gjak dhe e kanë parë me sytë e vetë rrahjet
7 e mëtepërta dhe të mëtejshme që ai pësoi, ndërkohë që edhe
8 keqtrajtohej vetë, nga i akuzuari dhe nga bashkëpunëtorët e
9 tij.

10 Një të ndaluarit iu tregua, iu tha, që të rrihte 04733 dhe
11 kur nuk pranoi ta bënte një gjë të tillë, ai u rrah vet shumë
12 ashpër.

13 Kur i akuzuari dhe bashkëpunëtorët e tij mbaruan me të
14 rrahurin e 04733, ata e morën zvarrë e nxorën nga dhoma, sepse
15 ai nuk mund të ecte më, nuk dilte dot me këmbët e veta nga
16 dhoma. Në korridor, keqtrajtimet vazhduan derisa atë e dërguan
17 përsëri në qeli. Ndërkohë që po largohej, rrahja e të
18 burgosurve të tjerë, përfshirë këtu edhe Dëshmitarin e
19 Gjykimit 4-01 dhe viktimën e vrasjes së paligjshme në këtë
20 çështje, filluan paralelisht.

21 Ndërkohë që abuzonin me viktimat, kryesit e këtij krimi i
22 akuzonin ata që kishin lidhje personale ose profesionale me
23 individë serbë ose institucione serbe. Rrahjet zgjatën deri të
24 nesërmen në mëngjes dhe shkaktuan dëme të rënda, gjakderdhje
25 të konsiderueshme dhe dhimbje ekstreme për viktimat.

1 Pas pak ditësh pas natës së rrahjes brutale në ndërtesën
2 e komandës, 4733 dhe personat e tjerë të ndaluar u transferuan
3 nga qelia e tyre në ndërtesën e komandës duke kaluar përmes
4 oborrit dhe duke u dërguar tek ndërtesa e ndalimit. Juve ju
5 tregua një foto e ndërtesës së ndalimit gjatë vizitës virtuale
6 të ambienteve të fabrikës dhe dëgjuat gjithashtu që prej asaj
7 kohe dhe deri tani ndërtesa është shkatërruar. Atje, ata u
8 bashkuan me një tjetër grup të ndaluarish.

9 Ndërtesa e ndalimit kishte tre dhoma. Dy prej të cilave
10 përdorshin për të mbajtur të ndaluarit. Rreth nëntë të
11 ndaluar ishin të ngjeshur me njëri-tjetrin në njërin prej
12 këtyre dhomave. Dhoma kishte dritare me hekura. Ishte e
13 mbyllur dhe ruhej me armë nga ushtarët e UÇK-së. Të ndaluarit
14 nuk mund të largoheshin nga dhoma, me përjashtimin e katër
15 prej tyre të cilët u detyruan të bënin punë me forcë dhe u
16 detyruan që të pastronin tualetet e pista dhe që të ngarkonin
17 dhe të shkarkonin kamionët që vinin për UÇK-në në fabrikën e
18 përpunimit të metaleve në Kukës.

19 Për të përdorur tualetin në ndërtesën tjetër, të
20 ndaluarit duhej që të kërkonin leje. Tualetet apo ambientet e
21 tilla që të ndaluarit lejoheshin që të përdornin ishin në
22 kushte shumë të këqija higjienike dhe ata gjatë rrugës për
23 atje ngacmoheshin në mënyrë të rregullt nga ushtarët e UÇK-së.
24 Njëri prej tyre, për shembull, u përpoq që t'i qëllonte me
25 thikë të ndaluarit ndërkohë që ato po kalonin nga ndërtesa ku

1 mbaheshin të ndaluar në ndërtesën ku gjendeshin tualetet.

2 Dhoma e ndalimit nuk kishte orendi, nuk kishte as krevate
3 dhe as dyshekë. Të ndaluarit mundoheshin që të flinin të
4 shtrirë në mure ose në dyshe-menë me rërë. Ata merrnin ujë për
5 të pirë, ushqimi ishte i pakët dhe ata nuk morën kujdes të
6 përshtatshëm mjekësor ose nuk morën fare kujdes mjekësor.

7 Abuzimi fizik dhe psikologjik nga i akuzuari dhe nga
8 pjesëtarë të tjerë të UÇK-së vazhdoi edhe pas natës së rrahjes
9 brutale në ndërtesën e komandës më ose rreth datës 20 maj
10 1999. Më pas, Dëshmitarët 04733 dhe persona të tjerë të
11 mbajtur të ndaluar me të iu nënshtruan rrahjeve të
12 vazhdueshme, përçmimeve, marrjeve në pyetje dhe kërcënimeve.

13 Disa viktima u lanë mënjanë dhe iu nënshtruan veçanërisht
14 trajtimit të ashpër dhe lëndimeve të rënda. Dëshmitari i
15 Gjykimit 4-01 ishte njëri prej tyre. I akuzuari personalisht
16 ka marrë pjesë në keqtrajtimin e tij në të paktën dhjetë raste
17 të veçanta. Gjatë njërit prej tyre, Dëshmitari i Gjykimit 4-01
18 iu tha që të vishte një jelek kundër plumbi edhe u qëllua në
19 drejtim të tij, duke e lënë 4-01 me traumë me dhimbje dhe me
20 vështirësi në të marrët frymë.

21 Një i burgosur nuk mbijetoi, ai nuk i mbijetoi ndalimit
22 dhe torturës që pësoi në Kukës.

23 Më 4 qershor 1999, viktima e vrasjes në këtë çështje dhe
24 Dëshmitari i Gjykimit 4-01 u larguan, u morën nga dhoma ku
25 mbaheshin në godinën e ndalimit. Ata u rrahën në mënyrë

1 kafshërore dhe u qëlluan nga një anëtar i UÇK-së. Viktima e
2 vrasjes së paligjshme u qëllua në këmbë. Atij vetëm iu dha
3 kujdes bazë mjekësor. Personeli i UÇK-së refuzoi që ta
4 dërgonte atë në spital. Por në vend të kësaj, ata vazhduan që
5 ta përçmonin dhe ta kërcënonin atë. Për rrjedhojë, viktima e
6 vdekur vdiq, pra, për shkak të këtyre keqtrajttimeve ose më
7 datë 5 qershor 1999 ose rreth kësaj date.

8 Gjatë këtij gjykimi, të nderuar Gjykatës, ju do të
9 prezantoheni me deklaratat e personave që kanë mbijetuar nga
10 ndalimi i tyre në fabrikën e përpunimit të metaleve në Kukës.
11 Ata kanë mbijetuar dhe u liruan ose për shkak të lidhjeve
12 personale ose janë liruar nga KFOR-i gjerman në mes të
13 qershorit të vitit 1999 pasi u transferuan në rajonin e
14 policisë në Prizren. Asnjë nga të ndaluarit nuk është referuar
15 asnjëherë për një shqyrtim gjyqësor apo për një vendim të
16 lidhur me ndalimin e tyre.

17 Dëshmitari 04733 u lirua për shkak të ndërhyrjes së
18 Shërbimit të Inteligjencës Shqiptare në fillim të qershorit
19 1999. Kur u kthye në familjen e tij, ata, anëtarët e familjes
20 mezi e njohën.

21 I ndaluar në Kukës ose ndalimi në Kukës nuk ishte vetëm
22 thjesht traumatizues për viktimat por ishte traumatizues edhe
23 për familjet e tyre.

24 Dëshmitari 04733 kishte gjurmë, kishte plagë që i kishin
25 ngelur nga keqtrajtimi në fabrikën e përpunimit të metaleve në

1 Kukës. Ai ishte i palarë, i mbuluar me gjurmë gjaku dhe kishte
2 humbur shumë peshë. Dëshmitari 4733 kishte pësuar lëndime
3 fizike dhe psikologjike gjatë ndalimit të tij në fabrikën e
4 përpunimit të metaleve në Kukës, dëmtime të cilat vazhdojnë
5 për gjithë jetën e tij. Anëtarët e familjes përshkruajnë sesi
6 një herë Dëshmitari 4733 u kthye tek këta dhe sesi e kanë parë
7 me sytë e tyre shenjat e keqtrajtimit që kishte pësuar dhe si
8 kishin dëgjuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Dëshmitari 4733
9 atë çfarë i kishte ndodhur, makthin që i kishte ndodhur. Ata
10 do të dëshmojnë gjithashtu lidhur me efektet e ndalimit të tij
11 në Kukës, pra, çfarë efektesh kishte ky ndalim mbi ta dhe
12 barrën që i ishte shkaktuar të gjithë familjes.

13 Një pjesë e dëshmive në këtë gjykim janë dhënë nga
14 dëshmitarë të cilët nuk janë më në gjendje që të japin dëshmi
15 në Gjykatë në këtë proces gjyqësor, ose për shkak të faktit
16 sepse ata kanë vdekur ose nuk janë të përshtatshëm për të
17 dhënë dëshmi në Gjykatë. Deklaratat e këtyre dëshmitarëve,
18 megjithatë, mbështeten nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë të
19 cilët do të vijjnë në sallën e gjyqit dhe që do të japin dëshmi
20 përpara jush të nderuar Gjykatës në kuadrin e këtij gjykimi.

21 Provat e paraqitura gjatë këtij procesi gjyqësor nuk do
22 të lënë pikë dyshimi që krimet e luftës të ndalimit arbitrar,
23 trajtimit mizor, torturës, për shumë të ndaluar si dhe vrasja
24 e njërit prej tyre ka ndodhur në fabrikën e përpunimit të
25 metaleve në Kukës gjatë periudhës së aktakuzës.

1 Kolegu im tani do të dëshmojë, do të ilustrojë sesi ZPS-
2 ja do të provojë që i akuzuari mban përgjegjësi penale për
3 këto krime sikurse ato parashtrohen në aktakuzë.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përpara
5 sesa të filloj, kam parasysh kohën. Thjeshtë dëshiroj t'ju
6 them që do të më duhen afërsisht 15 minuta për të përfunduar
7 këtë pjesë të prezantimit.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Prokuror, atëherë ju sugjeroj që të përfundoni brenda kësaj
10 kohe, me përjashtim të rasteve kur mbase mund të mendoni që do
11 të zgjatet 15 minutëshi, në këtë rast ju lutem na thoni.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, patjetër.

13 Të nderuar Gjykatës, i akuzuari, Pjetër Shala, mban
14 përgjegjësi penale për krime të paraqitura në aktakuzë dhe që
15 sapo u përshkruan nga kolegja ime. Provat do të tregojnë që ai
16 ishte anëtar i një grupi të vogël kriminal të ushtarëve të
17 UÇK-së që kanë kryer këto krime në fabrikën e përpunimit të
18 metaleve në Kukës. Prokuroria do të paraqesë prova që tregojnë
19 që ai është përgjegjës për këto krime si person i cili i ka
20 kryer ato fizikisht dhe si pjesëmarrës i NKP-së dhe si
21 ndihmues dhe inkurajues.

22 Në vitin 1998, të nderuar Gjykatës, i akuzuari ishte
23 anëtar i UÇK-së në Jabllanicë, në Kosovë. I akuzuari njihej
24 gjithashtu me pseudonimin Ujku. Sikurse do ta mësoni të
25 nderuar Gjykatës, kjo është një hollësi e rëndësishme. Për

1 shembull, për 04733 ai kujton se i akuzuari, pas arrestimit në
2 fabrikën e metaleve në Kukës, pra, i akuzuari bënte një zhurmë
3 si të ujkut. Pra, në momentin kur ai ishte në veprim e sipër
4 bënte këtë tingullin e ujkut.

5 Në verën e vitit 1998, i akuzuari u largua nga lufta në
6 Kosovë dhe shkoi në Belgjikë. Ka qëndruar atje për mbase
7 gjysmën e marsit të vitit 1999, kur vendosi që të kthehej
8 përsëri në rajon. Ai udhëtoi drejt Shqipërisë duke mbërritur
9 në Durrës. Pasi mbërriti atje, iu tha që shkonte në Kukës dhe
10 të bëhej pjesë e Brigadës 128 të UÇK-së në zonën e Pashtrikut.

11 I akuzuari u la që të besonte që ai do të kishte një lloj
12 roli komandues në atë brigadë, por pasi mbërriti atje, atij ju
13 bë e qartë që nuk do të ndodhte kështu. I zhgënjyer, i
14 akuzuari u largua pas pak ditësh, disa ditësh edhe shkoi në
15 frontin e luftës në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

16 Të nderuar Gjykatës, mbase e mbani mend nga diapozitivi i
17 parë që u tregua nga kolegja ime, që u botua publikisht, që
18 fabrika e përpunimit të metaleve të Kukësit nuk është larg
19 kufirit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

20 Dëshmitarë të shumtë, në fakt, qëndruan atje për një kohë
21 të konsiderueshme. Dhe do të kemi dëshmitarë të shumtë që do
22 të japin dëshmi që ai, në fakt, ka qenë i pranishëm, në fakt,
23 në fabrikën e përpunimit të metaleve në Kukës në momente
24 kritike për periudhën e aktakuzës.

25 Sikurse e thashë, të nderuar Gjykatës, provat e

1 Prokurorisë do të dëshmojnë se i akuzuari ka kryer krime si
2 anëtar i një grupi të vogël kriminal kryesisht krimesh. Ai nuk
3 ishte komandant i këtij grupi por ishte pjesëmarrës i
4 drejtpërdrejtë i cili ka kryer këto krime të pretenduara si
5 personalisht dhe së bashku me të tjerët. Përgjegjësia penale e
6 të akuzuarit buron nga pjesëmarrja e tij në akte që ose janë
7 filluar ose kanë çuar në zgjatjen e ndalimit të paligjshëm dhe
8 arbitrar të viktimave në fabrikën e përpunimit të metaleve. Ai
9 ka marrë pjesë gjerësisht gjithashtu në keqtrajtimin e
10 viktimave. Keqtrajtme të cilat në fund çuan në vrasjen e
11 paligjshme të njërit prej tyre.

12 Në këtë aspekt, të nderuar Gjykatës, ndërkohë që i
13 akuzuari formalisht nuk kishte një post të lartë brenda UÇK-
14 së, provat do të tregojnë që ai, në fakt, kishte një nivel të
15 lartë lirie dhe veprimi, që janë shumë të rëndësishme për këtë
16 çështje. Dhe këtu, për shembull, përfshihet mundësia e tij për
17 t'u futur dhe për të dalë nga vendi i krimit të pretenduar
18 sikurse ai dëshironte.

19 Të nderuar Gjykatës, në fakt, Prokuroria - edhe dua ta
20 bëj të qartë - që Prokuroria nuk pretendon që i akuzuari ka
21 qenë dhe rrinte i pranishëm në fabrikën e përpunimit të
22 metaleve në Kukës gjatë gjithë periudhës së aktakuzës. Por,
23 megjithatë, ai ishte i pranishëm atje në kohë kritike dhe ka
24 luajtur një rol domethënës në krimet e paraqitura në aktakuzë.

25 Kjo do të bëhet e qartë nga disa dëshmitarë në këtë

1 çështje. Për shembull, këtu përfshihen viktimat, për shembull,
2 04733, Dëshmitari i Gjykimit 4-01 dhe gjithashtu Dëshmitari
3 01448. Këtu përfshihen gjithashtu edhe ushtarë të UÇK-së që
4 kanë qenë të pranishëm dhe kanë qenë të pozicionuar në
5 fabrikën e përpunimit të metaleve në Kukës gjatë periudhës së
6 aktakuzës.

7 Së fundi, të nderuar Gjykatës, prania e të akuzuarit në
8 periudhën që lidhet me aktakuzën në fabrikën e përpunimit të
9 metaleve është e qartë nga vetë pranimet dhe deklaratat e tij
10 dhe ne, siç e thamë edhe në fillim të kësaj seance, këto janë
11 parashtrime që aktualisht po shqyrtohen nga Dhoma e Apelit.

12 Në këto deklaratat, i akuzuari përmes pranimeve të veta ka
13 pranuar aspekte të shumta të provave të Prokurorisë edhe të
14 dëshmive që do të parashtrohen përpara këtij procesi gjyqësor.

15 Për shembull, të nderuar Gjykatës, i akuzuari ka pranuar
16 që ka parë Dëshmitarin e Gjykimit 4-01 dhe viktimën e vrarë në
17 fabrikën e metalit në Kukës. Në fakt, ai ka pranuar që edhe i
18 ka rrahur ata.

19 I akuzuari ka pranuar gjithashtu që e ka parë 4733 në
20 fabrikë. Po ashtu edhe ajo çfarë është me rëndësi - është një
21 hollësi e rëndësishme - i akuzuari ka pranuar që e ka parë atë
22 të veshur me uniformë. Pra, 04733 po vishte një uniformë,
23 kishte veshur uniformë sepse kur u rrëmbye në Shqipëri,
24 familja e raportoi rrëmbimin e tij tek policia dhe policia po
25 e kërkonte, kështu që UÇK-ja, për ta transferuar atë në

1 fabrikën e përpunimit të metaleve dhe për të shmangur
2 postblloqet e policisë. Po pretendonin, domethënë, e kishin
3 veshur me uniformë për të pretenduar që ishte një ndër
4 ushtarët e UÇK-së.

5 Të nderuar Gjykatës, i akuzuari jo vetëm që ka qenë i
6 pranishëm në fabrikën e përpunimit të metaleve në Kukës,
7 dëshmia e shumë dëshmitarëve do ta vërtetojë këtë gjë dhe jo
8 vetëm kaq po edhe faktin që i akuzuari ka marrë pjesë në
9 mënyrë aktive në krimet e pretenduara. Pjesëmarrja e tij ishte
10 si e qenësishme dhe e gjerë. Më poshtë do të jap vetëm disa
11 prej shembujve të pjesëmarrjes së tij.

12 Rreth datës 18 [sipas përkthimit] maj 1999, përafërsisht
13 rreth kësaj date, i akuzuari ka marrë pjesë në transferimin e
14 04733 në fabrikën e përpunimit të metaleve në Kukës. Dhe e ka
15 bërë këtë gjë së bashku me ushtarë të tjetër të UÇK-së. Pra,
16 sikurse e thamë, 04733 mban mend që i akuzuari bërtiste si ujk
17 gjatë transferimit ose dhe në raste dhe të tjera ndërkohë që
18 vepronte në fabrikën e përpunimit të metaleve në Kukës.

19 I akuzuari ishte personi i parë që ka goditur Dëshmitarin
20 e Gjykimit 4-01 dhe viktimën e mbetur të vrarë kur kanë
21 mbërritur në fabrikën e Kukësit. Ndërkohë do të kemi
22 dëshmitarë të cilët do të shpjegojnë në hollësi pjesëmarrjen e
23 të akuzuarit në këto krime dhe në këto rrahje.

24 Të nderuar Gjykatës, kolegja ime ju përshkroi në hollësi
25 rrahjet ekstremisht të dhunshme që kanë ndodhur rreth datës 20

1 maj 1999 në ndërtesën e fabrikës së metaleve. I akuzuari ishte
2 i pranishëm në dhomë. Dhe këtë gjë e kemi konfirmuar përmes
3 dëshmisë së shumë dëshmitarëve. Së bashku me ushtarë të UÇK-
4 së, përfshirë këtu edhe anëtarë të NKP-së, ai në mënyrë
5 kafshërore ka rrahur Dëshmitarin e Gjykimit 4-01, 1448,
6 viktimën dhe 4733. Të tre dëshmitarët, të tre këta thonë që i
7 akuzuari ishte një prej kryesve të këtyre rrahjeve që ndodhën
8 atë natë.

9 Të nderuar Gjykatës, frika në dhomë atë natë është e
10 vështirë për t'u marrë me mend. I akuzuari dhe të tjerët
11 sulmuan në mënyrë kafshërore viktimat, persona të cilët ishin
12 të cenueshëm. Persona të cilët nuk kishin mundësi të
13 mbroheshin. Dhe ishin aty dhe nuk kishin asnjë opsion tjetër
14 përveçse të pranonin çdo gjë që bëhej mbi ta.

15 Siç ju thashë, të nderuar Gjykatës, këto janë vetëm
16 thjesht disa prej shembujve të pjesëmarrësve në krim të cilët
17 kanë edhe forma të tjera. Për shembull, kemi prova, kemi
18 dëshmi, që tregojnë që i akuzuari i ka detyruar të ndaluarit
19 që të kryejnë punë me forcë gjatë ndalimit të tyre.

20 Fatkeqësisht, të nderuar Gjykatës, dy prej viktimave,
21 Dëshmitari 04733 dhe 01448, kanë vdekur. Ne nuk do të kemi
22 mundësinë që të dëgjojmë historinë e tyre në sallën e gjyqit.
23 Megjithatë, ne do të dorëzojmë deklaratat e tyre dhe do t'i
24 kërkojmë që ato të futen në prova.

25 Të nderuar Gjykatës, përveç mohimit të pjesëmarrjes në

1 krime, sikurse u tha edhe nga z. Whiting, Mbrojtja ka sulmuar
2 në mënyrë të vazhdueshme si hetimet në këtë çështje dhe
3 besueshmërinë e një dëshmitari të veçantë të Prokurorisë është
4 Dëshmitari i Gjykimit 4-01. Ata thonë që ky dëshmitar ka dhënë
5 dëshmi të rreme në të shkuarën, që ai nuk është i besueshëm
6 për shkak të rekordeve të tij penale.

7 Të nderuar Gjykatës, Dëshmitari 4-01 ka dhënë dëshmi të
8 rreme në të shkuarën. Ai ka dhënë deklarata të caktuara
9 inkriminuese dhe më pas ka pranuar dhe ka shpjeguar se përse
10 ka dhënë dëshmi të tjera shfajësuese. Të nderuar Gjykatës,
11 dëshmitari do të trajtojë këtë çështje, do ta keni përpara.
12 Ndërkohë që ju, të nderuar Gjykatës, do të keni mundësinë që
13 t'i bëni pyetje të drejtpërdrejta atij.

14 Të nderuar Gjykatës, Dëshmitari i Gjykimit 4-01 ka një
15 historik penal. ZPS-ja nuk e mohon këtë. Por mbetet fakt që ai
16 gjithashtu ka qenë viktimë në fabrikën e Kukësit. Dhe këto dy
17 gjërat, të nderuar Gjykatës, nuk janë në mospërputhje me
18 njëra-tjetrën. Historiku i tij penal nuk do të thotë që ai nuk
19 meriton drejtësinë.

20 Ky dëshmitar ka dhënë shumë dëshmi ndër vite. Në
21 deklarata, ai gjithmonë në mënyrë konsistente ka implikuar të
22 akuzuarin në keqtrajtimin e tij dhe ka akuzuar atë edhe në
23 kryerjen e krimeve të tjera në fabrikën e metaleve në Kukës.

24 Të nderuar Gjykatës, në fund fare, ju takon juve që ta
25 dëgjoni këtë dëshmitar dhe të vlerësoni besueshmërinë e tij në

1 kuadrin e gjithçkaje që i ka ndodhur atij dhe të gjithë
2 dëshmisë që ai do të japë para Gjykatës. Varet nga ju që
3 vlerësoni besueshmërinë e tij në qoftë se ai ka qenë viktimë e
4 akteve të dhunshme, akteve të shumta të cilat janë kryer nga i
5 akuzuari dhe anëtarë të tjerë të NKP-së. Jeni ju, të nderuar
6 Gjykatës, që do të vlerësoni sesi dhe në çfarë mënyre kjo
7 provë konfirmon, kjo dëshmi konfirmon provat e tjera të cilat
8 do të jepen nga dëshmitarë të tjerë në këtë Gjykatë.

9 Në fund, të nderuar Gjykatës, në varësi të rezultatit të
10 Gjykatës së Apelit, ju mund të vlerësoni dhe të deklaratën e
11 vetë të akuzuarit, pranimin e vetë të akuzuarit që ai ka
12 rrahur Dëshmitarin e Gjykimit 4-01, ka rrahur viktimën e
13 vrasjes dhe arsyet se pse i ka rrahur ata.

14 Në fund, jeni ju, të nderuar Gjykatës, që do të vlerësoni
15 në qoftë se Dëshmitari 4-01 po e sajon historinë, siç
16 pretendon i akuzuari tani, ose në qoftë se ai po tregon të
17 vërtetën lidhur me të gjitha krimet për të cilat akuzohet i
18 akuzuari në këtë proces gjyqësor.

19 Përpara sesa të përfundoj, më lejoni të them dy fjalë
20 lidhur me deklaratat e të akuzuarit të cilat me ç'ë dinë të
21 gjithë janë përpara shqyrtimit në nivelin e apelit. Të nderuar
22 Gjykatës, me progresin e gjykimit do të doja që t'ju ftoja që
23 të mendoni për vetë pranimet që ka bërë i akuzuari në këtë
24 çështje, të cilat janë përsëritur me kalimin e viteve, e kam
25 fjalën këtu për rolin për krimet e kryera në Kukës, pra, çfarë

1 roli ka luajtur ai. Të nderuar Gjykatës, ju do shihni që ai ka
2 dhënë vetëm thjesht një pjesë të asaj çfarë ka ndodhur, një
3 pjesë të përfshirjes së tij në krime. Ai është përpjekur që të
4 minimizojë përgjegjësinë që, në fakt, është shumë më e gjerë
5 sesa ajo çfarë ka pranuar ai. Përmes deklaratave dhe dëshmive
6 të dëshmitarëve në gjykim, ZPS-ja do të provojë përgjegjësinë
7 e plotë të përfshirjes së të akuzuarit.

8 Në përmbyllje, të nderuar Gjykatës, kjo është një çështje
9 dhune, është një çështje mizërie, sulmi i dinjitetit njerëzor,
10 është një çështje e cila ka ndodhur brenda pak a shumë dy
11 javësh në një vend të vogël në pjesën veriore të Shqipërisë.
12 Nuk është një çështje e komplikuar. Krimet janë kryer nga
13 anëtarë të caktuar të UÇK-së. Dhe i akuzuari ishte njëri prej
14 personave që kanë kryer krime. Përgjegjësia e tij përfshin
15 gjithashtu edhe vrasjen e viktimës në këtë çështje. Dëshmitë
16 që do të paraqesë Prokuroria në gjykim do të provojnë përtej
17 dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari kishte synim specifik për
18 kryerjen e këtyre krimeve. Në mënyrë alternative dhe të paktën
19 ishte e parashikueshme për të akuzuarin që mund të shkaktohej
20 vrasja e dikujt.

21 Mendoni pak për armët e përdorura gjatë këtyre
22 keqtrajttimeve. Ekzistonte mundësia që këto mjete që ishin
23 mjete vdekjeprurëse, domethënë, janë mjete të cilat përfshinin
24 shkopinj gome, thika, armë zjarri. Kështu që për pasojë ishte
25 e parashikueshme që mjete të tillë mund të çonin edhe në

1 vdekjen e ndonjë personi.

2 Në fund, të nderuar Gjykatës, më lejoni të them që përmes
3 provave që do të paraqesë ZPS-ja gjatë gjykimit, ZPS-ja do të
4 provojë përtej dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari është
5 fajtor dhe mban përgjegjësi penale për krimet e parashikuara
6 nga Pika 1 deri në Pikën 4 të aktakuzës.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
8 Prokuror, faleminderit. Faleminderit shumë Zyrës së
9 Prokuroritë të Specializuar për deklaratën hapëse të kësaj
10 paraditeje.

11 Ka ardhur koha të bëjmë pushimin e kafesë. Pas pushimit
12 të kafesë do të vijojmë më tej me deklaratën hapëse të
13 Mbrojtjes së Viktimave dhe, në fund, pra, në fund të
14 deklaratës tuaj hapëse, do të diskutoj shkurtimisht kërkesën e
15 bërë nga Trupi Gjykses lidhur me parashtrimet që do të bëhen
16 lidhur me seancat përmes përdorimit të videolidhjes për tre
17 dëshmitarët. Faleminderit për vëmendjen.

18 Këtu përfundon pjesa e paradites.

19 --- Pauza fillon në orën 11.07

20 --- Seanca rifillon ne orën 11.36

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Uluni, ju lutem.

23 Mirë se erdhët.

24 Unë po shoh të pranishmit në sallë dhe kam idenë që nuk
25 ka ndryshime te personat pjesëmarrës.

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Mbrojtësi i Viktimave?

4 Z. LAWS: [Përkthim] Po, të njëjtët persona.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zyra

6 Administrative? Po?

7 Nga Mbrojtja, a janë të njëjtën persona ende?

8 Z. AOUBINI: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Thjeshtë do t'ju bëj
9 me dije që mund të kemi një ndryshim sepse kemi tashmë edhe
10 një pjesëmarrës tjetër, të cilit nuk ja them dot mbiemrin.
11 Është nga Turqia. Ju kërkoj ndjesë se nuk ja shqiptoj dot
12 mbiemrin, e kam të vështirë. Po kemi tre stazhierë, tre
13 praktikantë, dhe u dhamë mundësinë që të na dëgjojnë. Ju
14 faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
16 faleminderit. E shënojmë për procesverbal.

17 Në rregull. Mbaruam me deklaratat hyrëse të Prokurorisë
18 dhe tani e ka radhën Mbrojtësi i Viktimave.

19 A mund të na thoni sa kohë mendoni se do ju nevojitet?

20 Z. LAWS: [Përkthim] Ne thamë fillimisht dy orë, por më
21 shkurt se atë. Mendojmë se një orë e gjysmë, një orë e
22 pesëdhjetë minuta. Të shohim.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
24 të shohim si do të ecim. Pas deklaratave hyrëse, Trupi Gjykses
25 do të trajtojë dy pika përpara se të mbylлим seancën e ditës

1 së sotme.

2 Z. LAWS: [Përkthim] Mbase 10-15 minutat e fundit mund të
3 bëhen nga bashkë-avokatja, kështu që do të kemi një pushim
4 krejt të natyrshëm , në fakt, mes këtyre dy ndërhyrjeve.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
6 do ta mbyllim në orën dhe do të takohemi pas pushimit të
7 drekës. Sepse për ndryshe do të na duhej të shtynim shumë
8 pushimin e drekës dhe nuk është e drejtë për përkthyesit.

9 Z. LAWS: [Përkthim] Mirë, po të shohim si do të shkojmë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
11 atëherë, fjala është për ju.

12 Z. LAWS: [Përkthim] Provat në këtë çështje gjyqësore
13 tregojnë se periudha -- në periudhën e aktakuzës fabrika e
14 metalit në Kukës ishte një vend që, për nga pikëpamja e
15 kuadrit kohor, ka ekzistuar përtej sundimit të ligjit.
16 Rrëmbeheshin njerëz dhe i çonin atje. Nëse ishin atje, i
17 mbyllnin në një qeli thjeshtë për një tekë të një komandanti.
18 As nuk diskutohej të rishikohej ndalimi i tyre, e jo më pastaj
19 apeli. Vendimet për ndalimin merreshin në mënyrë krejt
20 arbitrare, të nxitura nga pretendime të kota, për bashkëpunim.

21 Kur ishin atje të ndaluar, ata që ishin përgjegjës
22 shfrytëzonin mundësinë për t'i marrë në pyetje të ndaluarit me
23 një mizori intensive. I rrihnin i digjnin, dhe i kaloni në
24 rrymë. Dëgjonin njëri-tjetrin teksa ulërinin dhe e dinin se
25 kishin radhën. Jetonin në kushte të tmerrshme dhe ditët e

1 tyre, ishin të mbushura me dhimbje dhe frikë.

2 Përshtypja e rrëmbyeseve të tyre sa i takon pa
3 ndëshkueshmërisë që mund të bënin çfarë të donin pa kurrfarë
4 pasoje forcohej te ta. Mizoria e tyre rritej dita ditës.

5 Në fund u vra një burrë. U mor jeta e një të riu krejt pa
6 sens dhe pa kuptim.

7 Viktimat dhe të tjerët thonë se i akuzuari, Pjetër Shala,
8 luajti edhe ai rolin e vet në të gjitha këto krime.

9 Ai dhe të tjerët me të përdoqën personat e dobët dhe të
10 cenueshëm ndaj forme abuzimi, për të cilat vendosnin gardianët
11 e tyre.

12 Në tërë këtë dhunë dhe mizori për të cilën do të flasim
13 më vonë, viktimat nuk mund ta ngrinin zërin. Do të shohim se
14 si atyre nuk u lejohej të flisnin as me vedi. Në fakt, flisnin
15 me zë të ulët, pa dyshim tërë ankth, e pëshpëritnin.

16 W04733 tha që:

17 "Ne i pëshpëritnim njëri-tjetrit në vesh, se nuk guxonim
18 të flisnim me zë të lartë se mos na përgjonin nga jashtë".

19 Një tjetër tha:

20 "Nuk na lejohej të flisnim me njëri-tjetrin. Deri sa
21 rrinim të shtrirë të molitur në dysHEME të fortë, bisedonim
22 duke pëshpëritur."

23 Në këtë proces, zërat e atyre që vuajtën në Kukës do të
24 dëgjoen. Edhe zërat e atyre që tashmë nuk jetojnë më,
25 dëshmitë e të cilëve jetojnë në dëshmitë e atyre dhe në

1 kujtimet e familjarëve të tyre.

2 Nga pikëpamja e viktimave kjo është një nga aspektet më
3 të rëndësishme të kësaj gjykate. Dëmi që vuajtën ata do të
4 njihet, do të pranohet. Fakti se të gjithë janë viktima po
5 ashtu do të pranohet.

6 Nuk është e thjeshtë të jesh viktimë në çështje gjyqësore
7 si kjo. Siç e ka pranuar kjo gjykatë në gjykimin e -- ekziston
8 klima e frikësimit në Kosovë ndaj atyre që pranojnë të
9 ndihmojnë këtë gjykatë në punimet e veta.

10 Në Kosovë disa përpiqen t'i portretizojnë viktimat e
11 krimeve që kanë kryer anëtarë të UÇK-së si tradhtarë, apo
12 kolaboracionistë. Unë dua të them këtë për llogari të tyre:
13 Këta viktima ishin mbështetës të UÇK-së, jo armiq të saj.
14 Fakti që akuzojnë këta anëtarë të UÇK-së, Pjetër Shalën, në
15 asnjë mënyrë nuk është formë për të dënuar UÇK-në në vetvete.

16 Viktimat në këtë çështje gjyqësore kanë vuajtur për shkak
17 të sjelljes së Pjetër Shalës dhe të tjerëve. Nuk është e
18 drejtë që të vuajnë përsëri duke i quajtur jo besnikë ndaj
19 Kosovës. Absolutisht nuk janë persona të tillë.

20 Po viktimat çfarë duan këtu?

21 Duan që të pranohet dëmi që kanë vuajtur, dhe bashkë-
22 avokatja ime do t'ju tregojë më në hollësi nga fundi i
23 deklaratave hyrëse lidhur me këtë pikë. Por ama duam edhe një
24 rezultat të drejtë për këtë çështje gjyqësore. Dhe sipas tyre,
25 një rezultat i drejtë është që z. Shala të pranojë fajësinë e

1 tij dhe kjo fajësi të vërtetohet.

2 Ai e mohon këtë, madje sikurse edhe e dëgjuat, siç e
3 thamë në mëngjes, shkon edhe më larg se kaq. Ai pretendon se
4 këto janë përralla për këtë, po tregojnë përralla për këtë, po
5 trillojnë. Dhe për shkak të kësaj ne, për llogari të atyre që
6 kanë vuajtur, do të shohim, do të përpiqemi të ndihmojmë
7 Trupin Gjykues që të zbulojë të vërtetën në këtë çështje
8 gjyqësore. Dhe ne këtë do ta bëjmë sepse viktimat pjesëmarrëse
9 në këtë proces kanë të drejtën për të zbuluar të vërtetën.

10 Ajo që do të bëj unë tani do të shohim disa nga dëshmitë
11 që kemi për këtë çështje gjyqësore.

12 Tani kur t'i shohim këto prova në mënyrë të drejtë, t'i
13 analizojmë, do të dalë në fund kush po gënjen dhe kush po
14 thotë të vërtetën këtu. E vërteta është se provat në këtë
15 çështje implikojnë Pjetër Shalën dhe tregon se ai vërtetë
16 është fajtor. Megjithatë, për ta bërë këtë, duhet të shohim
17 dëshmitë në hollësi.

18 Dhe për këtë fatkeqësisht nuk mund ta bëjmë në seancë të
19 hapur për shkak të masave mbrojtëse që janë në fuqi.

20 Do ju lutesha të kalonim në seancë private në këtë pikë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
22 Sekretare e Gjykatës, a mund të kalojmë në seancë private, ju
23 lutem?

24 [Seancë private]

25 [Seancë private teksti i fshirë]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7 [Seancë e hapur]

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 jemi në seancë të hapur.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit, zonja ndihmëse e seancës.

12 Marrim një pushim.

13 --- Pauza fillon në orën 12.16

14 --- Seanca rifillon në orën 12.28

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni
16 ju lutem.

17 Jemi në seancë të hapur dhe kemi vendimin e Trupit
18 Gjykes i cili do të jepet në seancë publike për shkak se nuk
19 do të flas mbi tematikën që ka të bëjë me provat materiale të
20 mundshme.

21 Janë dy pika mbi të cilat dua që të marr vendim, për sa i
22 përket Trupit Gjykes. E para: ka të bëjë me kundërshtimin
23 lidhur me përmbajtjen që është ngritur nga ana e palës
24 mbrojtëse. Trupi Gjykes bie dakord me Mbrojtësin e Viktimave
25 që diapozitivat janë njoftuar në kohën e duhur për të lejuar

1 mundësinë për të reaguuar dhe nuk ka pasur reagim të kësaj
2 natyre dhe ky kundërshtim hidhet poshtë.

3 Është sidoqoftë edhe një çështje tjetër, Mbrojtës i
4 Viktimave, për sa i përket deklaratave hyrëse, dhe nëse ato
5 duhen bërë në publik apo në seancë private. Trupi Gjykues e ka
6 bërë të qartë disa herë përmes korrespondencës me email që
7 deklaratat hyrëse duhet të bëhen në sasinë e mundur në seancë
8 publike. Dhe deklaratat hapëse juaj siç është tani, sipas
9 mendimit të Trupit Gjykues, nuk është në përputhje me këtë
10 rregull të përgjithshëm që kemi formuluar.

11 Dhe ajo që do të bëjmë tani është që do t'ju lejojmë juve
12 edhe 20 minuta të tjera për të diskutuar atë që deshët të
13 diskutonit për sa i përket prezantimit tuaj dhe për ta bërë
14 këtë në seancë private. Pastaj do të marrim pushimin prej një
15 ore e gjysmë, dhe më pas do të rifillojmë, dhe të japim pastaj
16 mundësinë për të vazhduar me deklaratën tuaj hyrëse, por në
17 seancë publike.

18 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit. Është me shumë ndihmë.
19 Kam pra 20 minuta për të përfunduar atë që dua të bëj në
20 seancë private dhe kjo është e mjaftueshme.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
22 sa i përket Trupit Gjykues dhe si një koment i përgjithshëm,
23 unë e kam kuptuar gabimisht komunikimin tuaj kur keni thënë që
24 keni një pjesë të parë, të dytë dhe të tretë dhe kur thatë që
25 pjesa e dytë do të ishte në seancë private. Nuk kisha pritur

1 që ajo do të ishte në seancë të mbyllur dhe të zgjasë kaq
2 shumë. Unë mendoja që do të kishim vetëm pesë minuta në seancë
3 të hapur dhe pastaj pesë minuta të tjera në fund.

4 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk e kishim synimin ta bëni një gjë
5 të tillë. E kam bërë të qartë që të gjitha diapozitivat do të
6 bëheshin në seancë private dhe këtë do të përpiqem që ta bëj
7 tani në mënyrë sa më të shpejtë që të jetë e mundur.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
9 Sekretare, a mund të kalojmë në seancë private, ju lutem?

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16 [Seancë e hapur]

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
18 jemi në seancë të hapur.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Avokati i Viktimave, me sa ç'kuptova, mbështetur në atë
22 çfarë thatë përpara se sa të fillonim me deklaratën
23 përmbyllëse, që dhjetë-pesëmbëdhjetë minutat e fundit do të
24 prezantohen nga bashkë-mbrojtësja e Viktimave. Kështu ishte?

25 Z. LAWS: [Përkthim] Po. Më duhen edhe dy minuta të tjera

1 për të folur përpara se t'i jap fjalën bashkë-mbrojtëses.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
3 në rregull, sepse normalisht pushimi është në orën 13.00.
4 propozimi për të vijuar pas pushimit të drekës ishte për të
5 bërë organizimin, për të kaluar në seancë publike. Megjithatë,
6 në qoftë se kjo nuk është e nevojshme, do të propozoja që të
7 mund të vazhdonim më tej me pjesën e deklaratës hapëse të
8 mbetur prej jush. Kështu që mund ta përfundojmë edhe përpara
9 orës 13.00 duke përfshirë, nëse më lejoni. Do të doja t'ju
10 kërkoja përkthyesëve dy minuta për dy pikat të cilat janë të
11 shkurtra. Do t'i diskutojmë, megjithatë janë çështje të
12 shkurtra dhe pastaj, do të vazhdojmë me pjesën e pasdites, në
13 mënyrë që të shtjellojmë gjëra të tjera të rëndësishme me
14 synimin që të vijojmë pastaj me deklaratën hapëse të Mbrojtjes
15 së të akuzuarve.

16 Këtë sugjerim kam unë për momentin. Shoh që palët
17 pajtohen, kështu që sërish fjala për ju, Avokat i Viktimave.

18 Z. LAWS: [Përkthim] Në përmbyllje, provat do të tregojnë
19 që Pjetër Shala ishte një prej kryerësve të veprave të
20 ndodhura në fabrikën e përpunimit të metaleve në Kukës.
21 Ekzistenca e kësaj gjykate tregon se viktimat në qoftë se kanë
22 kurajën, mund dhe do të dëgjohen pas shumë vitesh pasi janë
23 kryer krime të ndryshme mbi ta. Kryerësit e këtyre veprave, të
24 këtyre krimeve, që kanë një madhësi të tillë në fakt asnjëherë
25 nuk janë përtej ligjit.

1 Ata të cilët ishin të pafuqishëm asokohe, tanimë i kanë
2 fuqitë, i kanë kompetencat. Personat të cilët atëherë nuk
3 lejoheshin që të flisnin do të kenë mundësinë sot që të thonë
4 fjalën e tyre.

5 Me lejen tuaj, të nderuar anëtarë të Trupit Gjykses do i
6 kërkoj bashkë-mbrojtëses së Viktimave që të flasë për këtë
7 pjesë të fundit të prezantimit hyrës të viktimave.

8 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
9 Gjykatës.

10 Heqja arbitrare e lirisë, trajtimi mizor, torturë, vrasje
11 të paligjshme. Këto janë krimet për të cilat akuzohet z.
12 Shala. Viktimat e këtyre krimeve janë dëmtuar në mënyrë të
13 jashtëzakonshme. Njëri prej tyre nuk i ka mbijetuar makthit që
14 ju desh të kalonte. Dhe edhe ndonëse këto krime kanë ndodhur
15 më shumë se sa 20 vite më përpara, dëmtimet dhe vuajtjet e
16 shkaktuara prej tyre vazhdojnë që të ndikojnë mbi jetën e
17 përditshme të personave që i kanë kaluar ato.

18 Personat që janë ndaluar në fabrikën e përpunimit të
19 metaleve në Kukës nuk kanë marrë pjesë aktive në asnjë prej
20 luftimeve të UÇK-së. E kundërta ka qenë e vërtetë. Disa prej
21 tyre dëshironin që të kyçeshin në UÇK. Asnjë prej të ndaluarve
22 dhe të keqtrajtuar në fabrikën e metaleve të Kukësit nuk ka
23 marrë akuza zyrtare, as dhe nuk ka marrë ndonjë dënim për
24 krimet e kryera. Dhe pavarësisht kësaj, ata janë ndaluar dhe
25 janë trajtuar në mënyrat më mizore dhe më çnjerëzore të

1 mundshme.

2 Disa prej viktimave janë mbajtur në ambientet e fabrikës
3 së Kukësit për shumë kohë, për mbi një muaj. Ata janë rrahur
4 dhe keqtrajtuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndërkohë, ne sikurse
5 e dëgjuam përshkrimet e dëgjuam përshkrimet e asaj çfarë
6 ndodhi në Kukës, reflektojnë dëmin që kanë pësuar secili prej
7 tyre.

8 Ishin persona të cilët çdo ditë e çdo natë rriheshin.
9 Rriheshin me duar, me këmbë, me instrumente të ndryshme, me
10 shkopinj bejsbolli, shkopinj prej gome, me shufra metali, me
11 thika, me armë dhe me objekte të tjera të mprehta. Ndonjëherë
12 keqtrajtme të tilla zgjasnin gjatë gjithë natës.

13 Sipas dëshmisë së njëres prej viktimave, ata përdornin
14 shkopinj metali dhe shkopinj bejsbolli për t'i goditur në
15 kokë, në kurriz, në krahë dhe kudo që të mundnin. Dhe pas
16 goditjeve të tilla, një herë ai humbi ndjenjat. U mbulua në të
17 gjithë trupin me gjak. Ata madje i vunë edhe kripë në sy dhe
18 në plagë.

19 Dhe kjo nuk është e gjitha. Disa nga të ndaluarit janë
20 qëlluar dhe më pas ka vazhduar rrahja e tyre, pavarësisht
21 faktit që u ishin shkaktuar plagë nga të shtënat me armë. Ata
22 nuk morën kujdes mjekësor.

23 Personat e ndaluar në Kukës janë abuzuar edhe nga
24 pikëpamja psikologjike. Pikë së pari, ata janë ekspozuar ndaj
25 vuajtjeve të të tjerëve. Ata shpesh, ose mund të shikonin me

1 sytë e tyre, ose dëgjonin ndërkohë që të tjerët
2 keqtrajtoheshin. Ata u kërcënuan me vdekje ose me dëmtime të
3 rënda trupore. Disa prej tyre u urdhëruan që të rrihnin
4 personat e tjerë të bashkë-ndaluar me ta dhe u rrahën keq në
5 qoftë se refuzuan ta bënin këtë gjë.

6 Për të qenë të qartë, ky përshkrim i instrumenteve dhe
7 metodave të keqtrajtimit që viktimat kanë pësuar në fabrikën e
8 Kukësit, nuk është shterues, është larg të qenit shterues.

9 Ne mund vetëm të imagjinojmë se cilat kanë qenë ndikimet
10 e një trajtimi të tillë mbi jetët e njerëzve që i mbijetuan
11 atij dhe është e vështirë që të gjesh fjalë për të përshkruar
12 padrejtësinë e bërë ndaj këtyre njerëzve.

13 Shumë vite më pas, kur janë pyetur drejtpërsëdrejti për
14 pasojat e keqtrajtimit në fabrikën e Kukësit, njëri prej
15 viktimave përshkroi në mënyrë të përmbledhur që ai kishte
16 dhimbje në shtyllën kurrizore, në eshtra, vuante nga stresi, e
17 humbte toruan shpejt. Tha gjithashtu që i vinin në mendje herë
18 pas here keqtrajtimet që kishte vuajtur në kohën e në fjalë
19 dhe që nuk flinte mirë.

20 Ai thotë që frika i është ngulitur në kokë. Ai në fakt --
21 i vjen keq -- portretizimi i tyre -- portretizimi i personave
22 që e goditën dhe e keqtrajtuan si tradhtar.

23 Ai e ka të vështirë që të gjejë pozicionin dhe vendin që
24 ka në jetë. Ai thotë: "jam në mes, nuk jam as në tokë as në
25 qiell". Këtë na tha kur folëm me të.

1 Është e qartë që trauma e këtyre e ngjarjeve nuk i ka
2 kaluar asnjëherë personit në fjalë dhe mbase nuk do t'i kalojë
3 asnjëherë deri sa të jetë gjallë.

4 Krimet e ndodhura në fabrikën e Kukësit kanë ushtruar
5 ndikime edhe mbi jetën e personave të cilët nuk kanë qenë
6 brenda godinës. Atyre, anëtarët e familjeve janë torturuar
7 atje dhe edhe vetë anëtarëve të familjarëve të cilët janë
8 keqtrajtuar në Kukës edhe sot e kësaj dite qajnë kur pyeten
9 për ngjarjet që kanë ndodhur në atë kohë. Ata flasin për
10 traumë dhe për stres të jashtëzakonshëm të shkaktuar nga
11 arrestimi i anëtarëve të familjes. Ata flasin për traumë dhe
12 për stres që kanë ndjerë në momentin kur personat janë kthyer
13 nga Kukësi.

14 Ata flasin për humbje që nuk mund të fitohet dhe ata
15 flasin, për shembull, njëri prej tyre flet për babanë, burrin
16 që mbijetoi pas asaj çfarë kishte ndodhur në Kukës.

17 Ata flasin për stigmën sociale që vjen si rezultat i
18 këtyre ngjarjeve, stigma që i ka ndaluar ata që të ndjekin
19 shkollën, të gjejnë një vend pune, por edhe që janë kërcënuar
20 për përpjekjet e tyre për të kërkuar drejtësi lidhur me atë
21 çfarë ndodhi

22 Të nderuar Gjykatës është e rëndësishme të shpjegohet se
23 të afërmit e personave që janë ndaluar dhe janë keqtrajtuar në
24 fabrikën e Kukësit nuk janë në gjendje të flasin për veten.
25 Ata nuk duan që ta shtjellojnë më tej vuajtjen e tyre. Në të

1 njëjtën kohë, kur takohesh me ta, e ndjen përnjëherë që edhe
2 sot e kësaj dite, ata janë të prekur thelbësisht dhe
3 thellësisht lidhur me atë çfarë u ka ndodhur personave të tyre
4 të dashur. Kjo nuk ilustron domosdoshmërisht me fjalë, por
5 ilustron me lot dhe me insistimin e tyre për të mësuar se
6 çfarë ka ndodhur dhe cilat ishin arsyet e asaj çfarë ndodhi.

7 Gjatë këtij gjykimi do të dëgjojmë viktimat, dëshmitarë që
8 flasin për ndikimin e krimeve, të akuzuar në këtë çështje,
9 çfarë ndikimi kanë pasur këto krime mbi jetën e tyre. Pa këto
10 dëshmi është e pamundur që të nxirret një panoramë e plotë e
11 asaj çfarë ka ndodhur në fabrikën e Kukësit dhe të kuptohen se
12 sa të rënda kanë qenë krimet e ndodhura atje.

13 Ju takon ju, të nderuar anëtarë të Trupi Gjyqësor, që të
14 vendosni, të pranoni dëmtimin e pësuar nga viktimat e këtyre
15 krimeve, gjë që e cila është një nga objektivat kryesore të
16 këtyre proceseve gjyqësore.

17 Ajo çfarë është më me shumë vlerë për viktimat është që
18 të identifikohet se çfarë ka ndodhur, kryesisht pra çfarë kanë
19 qenë, cilat kanë qenë arsyet për këto ngjarje dhe kush ka qenë
20 përgjegjës për të. Po ashtu për ta është e rëndësishme që të
21 kenë mundësi që të marrin pjesë në këtë proces gjyqësor dhe që
22 dëmtimi që ata kanë kaluar të mund të pranohet plotësisht dhe
23 botërisht.

24 Faleminderit, ky është fundi i prezantimit të Mbrojtjes
25 së Viktimave.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Jemi në fund të deklaratave hapëse të Zyrës së Prokurorit
4 të Specializuar dhe të Avokatit të Viktimave.

5 Nesër do të vazhdojmë me deklaratën hapëse të z. Shala
6 dhe deklaratën jo nën betim të z. Shala.

7 Përpara se sa të përfundojmë me këtë seancë, ka dy gjëra
8 që do të doja t'ju sillja në vëmendje.

9 Njëra prej tyre ka të bëjë me kërkesën e ZPS-së të
10 depozituar me 13 shkurt të këtij viti, për një dëshmi përmes
11 videokonferencës për tre dëshmitarë, që bëhet fjalë për
12 parashtrimin e protokolluar 425. I kemi kërkuar përmes emailit
13 Mbrojtjes së të akuzuarit dhe Mbrojtjes së Viktimave që të
14 japin një përgjigje brenda seancës së parë të ditës së sotme,
15 në mënyrë të tillë që të kemi mundësi që t'i përgjigjemi
16 kërkesës së ZPS-së. Mbrojtja na ka informuar në një email që
17 na është dërguar dje në orën 15.43 që nuk është në gjendje që
18 ta bëjë këtë gjë dhe do të vazhdojmë që të marrim parashtrime
19 me shkrim lidhur me këtë çështje në përputhje me rregullin 76
20 të Rregullores.

21 Dua t'i kërkoj Avokatit të Viktimave në qoftë se do
22 përgjigjet me gojë nesër në lidhje me parashtrimin që përmenda
23 të ZPS-së ose në qoftë se do të na japë një parashtrim me
24 shkrim

25 Z. LAWS: [Përkthim] Mund t'ju përgjigjem me gojë sot ose

1 nesër. Thjesht dua t'ju them që ne nuk kemi kundërshtim me
2 kërkesën e depozituar nga ZPS-ja.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit për deklaratën tuaj.

5 Megjithatë, për shkak të faktit që do të presim një
6 parashtrim me shkrim nga Mbrojtja e të akuzuarit, do i kërkoja
7 Zyrës së ZPS-së që të jepte një përgjigje me shkrim në
8 përputhje rregullën 76 të Rregullores, për Mbrojtjen e të
9 akuzuarit. Pra, po mundohemi që të shmangim një vendim me
10 shkrim, e kuptojmë që është një kohë goxha e ngjeshur për të
11 gjithë.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e
13 kuptojmë, do të bëjmë një kundërpërgjigje me shkrim për
14 parashtrimin e Mbrojtjes së të akuzuarit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
16 një pikë të dytë që ka të bëjë me planifikimit të kalendarit.
17 Dua të pyes ZPS-në. Ne po mendojmë mundësinë të shtojmë, në
18 qoftë se palët pajtohen, dhe në qoftë se janë të disponueshëm,
19 pra planifikojmë dy ditë shtesë dhe të ndryshojmë një datë në
20 kalendar për çështjen 04. Data shtesë mund të jenë e premtja,
21 data 19 maj, dhe e premtja, data 16 qershor e këtij viti.

22 Dëshirojmë të diskutojmë sa më poshtë me palët me Zyrës
23 Administrative dhe me Mbrojtjen e Viktimave nesër, pasi të
24 dëgjojmë deklaratat hapëse të Mbrojtjes së të akuzuarit. Dhe
25 duam që të dëgjojmë nga ZPS-ja po ashtu në qoftë se është e

1 mundur që të thërrasim dëshmitarë në këto data. Duhet të jenë
2 dëshmitarët, ose nuk e di mund të jenë dëshmitarë ekspertë që
3 vlerësojnë që të japin një dëshmi për rreth dy orë, sepse janë
4 dëshmitarë që duhet që të përfundojnë dëshminë e tyre brenda
5 një dite, sepse bëhet fjalë për ditë të vetme. Domethënë,
6 bëhet fjalë për 19 majin dhe 16 qershorin. 16 qershori do të
7 zëvendësojë datën 13 qershor [sipas përkthimit], nëse do të
8 pranohet nga palët. Pra data 19 maj është datë shtesë që nuk
9 është planifikuar fillimisht në kalendar dhe data 16 qershor
10 është një datë që zëvendëson datën 13 qershor [sipas
11 përkthimit].

12 Sikurse e thashë, Trupi Gjykses shqyrtoi mundësinë
13 ndoshta Trupi Gjykses ndonjë dëshmitari ekspert, ose një
14 dëshmitari që do të japë dëshmi për një periudhë të kufizuar
15 kohe. Megjithatë, sigurisht, ja lemë në dorë ZPS-së që të
16 vendosë në qoftë se një zgjidhje e tillë është e përshtatshme.
17 Ose kush do të jetë dëshmitari që do të dëshmojë në këto data.
18 Dhe gjithashtu duhet të marrë parasysh edhe disponueshmëria e
19 dëshmitarëve. Pra, ka shumë faktorë që do të duhet të merren
20 parasysh. Lidhur me këto data. Trupi Gjykses po përpiqet që të
21 përdorë sa më mirë ditët që ka në dispozicion përpara pushimit
22 të verës. Pra një qëllim mund të jetë që çështje e ZPS-së të
23 përfundojë përpara pushimit të verës. Megjithatë le të shohim
24 se si do të ecë gjykimi, por propozimi im është që të përdorim
25 në maksimum të gjithë kohën që kemi në dispozicion.

1 Kështu që ju propozoj që të shikoni këto dy data dhe të
2 na thoni konstatime të mëtejshme. E kam fjalën këtu për të
3 gjitha palët. Për Zyrën Administrative, për ZPS-në, për
4 Mbrojtjen e Viktimave dhe për Mbrojtjen e të akuzuarve. Në
5 qoftë se do të na jepni një përgjigje nesër, jemi në rregull.

6 Mirë atëherë tani do t'ju kërkoj palëve që të më thonë në
7 qoftë se kanë ndonjë gjë tjetër për të shtuar, duke filluar
8 nga ZPS-ja. Zyrës e Prokurorisë, ka ndonjë gjë tjetër që doni
9 të ngrini?

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, asgjë për momentin.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Avokati i Viktimave?

13 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, asgjë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Mbrojtja e të akuzuarit?

16 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit për mundësinë, të
17 nderuar Gjykatës.

18 Dua që të them mbiemrin e koleges. Ju kërkoj ndjesë edhe
19 një herë, siç e thashë se e kisha vështirë që ta shqiptoja
20 mbiemrin e saj kështu që do të mundohem që për procesverbal ta
21 them tani.

22 Është zonja Zeynep Yanikomeroglu.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Faleminderit për këtë.

25 Jemi në fund të seancës së ditës së sotme. E mbyllim këtu

1 seancën dhe fillojmë sërish nesër në orën 09.30.

2 --- Seanca mbyllet në orën 13.01.

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25